



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

Tiranë, më 18.07.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Albana Vokshi – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Seancë dëgjimore me aktorë të interesit për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.”” (*komision përgjegjës*).

2. Diskutimi dhe votimi nen për nen dhe në tërësi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.”” (*komision përgjegjës*).

Marrin pjesë:

Albana Vokshi, Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Fatmir Velaj, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Adelina Rista, Bujar Çela, Almira Xhembulla, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Romeo Gurakuqi, Valentina Duka, Kejdi Mehmetaj, Shezai Rrokaj, Nora Malaj, Besnik Baraj (zëvendësues).

Të ftuar:

Arian Dyrmishi - kryetar i Federatës së Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës të Shqipërisë,
Nevrus Kaptelli – kryetar i Sindikatave të Pavarura të Arsimitarëve,
Kol Nikollaj – president i Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë (KSSH-së),
Hajrush Çollaku - sekretar i Përgjithshëm i Federatës së Arsimit, Edukimit dhe Shkencës,
anëtar i KSSH-së,

Albana Mustafaraj – përfaqësuese e Koalicionit për Arsimin në Shqipëri (ACE),

Klaudio Pulaha – përfaqësues i Koalicionit për Arsimin në Shqipëri (ACE),

Lirie Dina – përfaqësuese e qendrës “Për arsimin cilësor”.

Gentian Sejrani - përfaqësues i qendrës “Për arsimin cilësor”,
Altea Lula - përfaqësuese e qendrës “Për arsimin cilësor”,
Ekflodia Leskaj – përfaqësuese e Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF),
Jonida Lamaj - përfaqësuese e Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF),
Roland Zisi - rektor në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë,
Valbona Duri - zëvendësrektore e Universitetit “Eqerem Çabej”, Gjirokastrë,
Erana Bilali - përgjegjëse e Departamentit të Mësuesisë në Fakultetin e Shkencave të
Edukimit, Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër,
Besa Shahini – zëvendësministre e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë,
Zamira Gjini - drejtore e Përgjithshme për Politikën dhe Zhvillimin e Arsimit, Sportit dhe
Rinisë,
Gerti Janaqi - drejtor i Institutit të Zhvillimit të Arsimit,
Erzen Tola – drejtor në Drejtorinë e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të
Kadrit Rregullator,
Mariglen Mërtiri – këshilltar për mediat.

HAPET MBLEDHJA

I - Albana Vokshi – Mirëmëngjesi!

Sot kemi një seancë dëgjimore me aktorët e interesit, për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar””.

Të ftuar nga sindikatat janë: Arian Dyrmishi, kryetar i Federatës së Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës të Shqipërisë...

Të lutem, Arian, duhet të dalësh andej, nëse do të flasësh!

Nëse do të flisni, duhet të dilni aty ku ka mikrofon.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E ka i pari radhën.

Nevrus Kaptelli, kryetar i Sindikatave të Pavarura të Arsimitarëve; Kol Nikollaj, president i Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë (KSSH-së); Hajrush Çollaku, sekretar i Përgjithshëm i Federatës së Arsimit, Edukimit dhe Shkencës.

Nga Koalicioni për Arsimin në Shqipëri, Albana Mustafaraj.

Nga qendra “Për arsimin cilësor” janë të ftuar: Lirie Dina, Gentjan Serjani, Altea Lula.

Nga Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF) janë të ftuar: Ekflodia Leskaj, Jonida Lamaj.

Kemi ftuar edhe përfaqësues të fakulteteve të shkencave të edukimit, departamenti i mësuesisë.

Kanë konfirmuar pjesëmarrjen, për pjesën e dytë të kësaj dëgjese prof. dr. Roland Zisi, rektor në universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë; prof. asoc. Valbona Duri, zëvendësrektore e universitetit “Eqerem Çabej”, Gjirokastrë; dr. Erana Bilali, Halluni, përgjegjëse e departamentit të mësuesisë në Fakultetin e Shkencave të Edukimit, universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër.

Prof. dr. Skënder Topi, rektor i universitetit “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, njoftoi se e kishte të pamundur të vinte, sepse kishte provime. Gjithsesi, do të dërgojë një koment me shkrim.

Pa humbur kohë po ia kaloj fjalën zotit Dyrmishi, kryetar i Federatave të Sindikatave të Arsimit, Shkencës të Shqipërisë.

Ju lutem, shkurtimisht, me pika për projektligjin!

Mbase koha ka qenë pak e limituar për ju, sikurse edhe për ne. Gjithsesi, u munduam të organizonim një dëgjese, për të marrë, me aq sa kishim mundësi, opinionet e palëve të interesit në lidhje me një projektligj, që është i rëndësishëm në këtë moment, jo vetëm për ligjvënësit, por sidomos për sistemin e arsimit parauniversitar.

Faleminderit!

Arian Dymishi – Faleminderit, zonja kryetare, për ftesën në këtë diskutim!

Ne përgjithësi, ne mendojmë se rishikimi i ligjit është një hap i mirë, për sa kohë që gjatë zbatimit të tij të deritanishëm janë shfaqur probleme të ndryshme, të cilat duhen adresuar. Një nga këto është edhe fakti që do të ketë një përputhje të mëtejshme me sistemin e decentralizmit.

Për këtë arsye, mendojmë se në ligj duhet të dilnin pak më të qarta raportet që parashikohen të jenë midis ministrisë dhe njësive arsimore vendore, për aq kohë sa këto parashikohet të shtohen, pra nga 36 që janë aktualisht, të shkojnë në 61.

Njëkohësisht, ashtu siç parashikohet për ristrukturimin, krijimin e rajoneve, parashikohet të ketë edhe një raport marrëdhëniesh ndërmjet 4 rajoneve dhe këtyre njësive, për të cilat ky numër do të variojë. Pra, në njëfarë mënyre, në ligj është e paqartë se si do të funksionojë marrëdhënia vertikale ndërmjet këtyre 3 niveleve për sa i përket administrimit të proceseve, qoftë në zbatim, qoftë në monitorimin e zbatimit të legjislacionit.

Për momentin, këtë pikë kisha për të shtuar.

Ndoshta kolegët e tjerë mund të kenë ndonjë...

Faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit!

Ia kaloj fjalën zotit Nevruz Kaptelli, kryetar i Sindikatës së Pavarur të Arsimitarëve.

Nevrus Kaptelli – E nderuar kryetare,

Të nderuar deputetë,

Së pari, ju falënderoj për mundësinë që na keni krijuar duke na ftuar për të dhënë mendimet tona këtu!

Për hir të së vërtetës, MASR-ja ka filluar të kërkojë mendimin e sindikatave të arsimit, si partnere sociale, duke na ftuar edhe në fund të vitit të kaluar për të dhënë mendimet tona lidhur me ndryshimet që mendonim se duheshin bërë në ligjin nr. 69/2012 “Për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”.

Edhe pse nuk ishte normale, pasi duhej të na dërgoheshin propozimet që mendonte MASR-ja për ndryshimet, dërguam mendimet tona duke parë çdo nen të ligjit, ku një pjesë e tyre, që kanë të bëjnë me ndryshimet e diktuar nga ndryshimi i strukturave të qeverisjes vendore, janë reflektuar në projektligjin e paraqitur.

Çdo shtet në Europë dhe në botë, përpara se të ndërmarrë iniciativa për kryerjen e reformave, studion dhe identifikon sistemin aktual, si dhe traditën e shtetit në lidhje me sektorin që supozohet të reformohet.

Për fat të keq, këtu janë kopjuar reforma pa u bërë më parë ky studim dhe pa u identifikuar saktë praktika ndër vite, duke sjellë edhe pasoja negative në zhvillimin e vendit, në fushën e arsimit.

Viktimë e reformave të pastudiuara dhe të pakonsultuara më parë me partnerët socialë kanë rënë institucionet, si dhe vetë mësuesit dhe punonjësit e tjerë të sistemit arsimor, kjo për arsyen se ndërmjet institucioneve kemi evidentuar mbivendosje kompetencash të padrejta. Pasojat për personelin mësimor, në rastin më të keq, kanë përfunduar në largime të padrejta nga vendi i punës.

Dispozita në ligj, për mësuesit pa arsim përkatës, ka qenë totalisht e jashtëligjshme. Për të njëjtin fakt janë aplikuar dy standarde.

Në ligjin e vjetër për arsimin e lartë, për profesorët pa arsimin përkatës, ka pasur një afat 5-vjeçar për plotësimin e kualifikimit të tyre, ndërkohë që në sistemin e arsimit parauniversitar, për mësuesit pa arsim përkatës, dispozita ka pasur efekt të menjëhershëm, duke cenuar rëndë sigurinë juridike, duke i kushtuar shumë buxhetit të shtetit nga përfitimet që janë marrë në rrugë gjyqësore, nga të larguarit për këtë arsye.

Ne kemi kërkuar vazhdimisht që arsimi të jetë prioritet i qeverisë, duke kërkuar më shumë buxhet për arsimin, por fakti që buxheti për arsimin, edhe pas 5 vjetësh qeverisjeje, zë afër 36% të GDP-së, tregon se arsimin nuk i është kushtuar kujdesi i duhur dhe, në disa raste, nga veprimet e pastudiuara dhe të keqkopjuara janë marrë vendime që kanë cenuar arsimin, siç është rasti i arsimit profesional.

Është kundërshtuar veprimi i pastudiuar që arsimi profesional të kalonte fillimisht te Ministria e Punës dhe pastaj tek ajo e Financave. Ajo që kërkojmë është kthimi i menjëhershëm në varësi të MASR-së, siç funksionon në Gjermani dhe në Austri, shteteve të cilave iu referuan kur adoptuan kalimin e arsimit parauniversitar në varësi të Ministrisë së Punës, duke iu referuar sistemit dual gjerman dhe austriak.

Që në atë kohë kemi thënë se përderisa po i referoheni sistemit dual gjerman dhe austriak, zbatoheni të plotë atë.

Ku e ka Gjermania dhe Austria arsimin profesional? Dy shtetet, që ne iu adresuam dhe kopjuam, e kanë në varësi të Ministrisë së Arsimit. Atëherë?

Zëri ynë nuk u dëgjua. Dëshëm apo s'dëshëm ne, kaloi në Ministrinë e Punës. Ministria e Punës tashmë u shkri dhe arsimi profesional ka ngelur rrugëve. Më e keqja është se pretendohet që ky arsim ka ecur.

Është e vërtetë që është shtuar disi numri i nxënësve në arsimin profesional, por numri i mësuesve është po ai. 1200 mësues kanë qenë më parë dhe 1200 mësues janë edhe sot.

Le të krahasohemi pak vetëm me vendet e rajonit. Maqedonia ka një mesatare shumë të lartë, 50% në arsimin profesional. Po të shohim Kosovën, e ka arsimin profesional shumë më mirë se ne dhe kemi ku të marrim shembull.

Ne nuk kemi qenë dakord dhe nuk kemi mbështetur as kalimin e arsimit parashkollor në varësi të pushtetit vendor.

Nga eksperiencia e shteteve që e kanë aplikuar këtë sistem, si: Sllovenia, Kroacia e të tjerë, janë evidentuar rënie të nivelit cilësor në arsimin parashkollor pas kalimit në varësi të qeverisjes vendore.

Në takimet që zhvillojnë përfaqësuesit e ministrisë me ministrinë përkatëse të rajonit, mund ta konstatojmë se çfarë kujdesi i kushtohet arsimit parashkollor, kur është në varësi të qeverisjes vendore dhe cili është kujdesi kur e ka vetë Ministria e Arsimit nën kontroll.

Praktika e këtyre shteteve që unë përmenda, por edhe të tjera me të cilat ne konsultohemi, ka treguar se kjo nuk i ka shërbyer rritjes së cilësisë së arsimit dhe do të ishte mire, meqë bëhen edhe rishikime në ligjin e arsimit parauniversitar, që ashtu si arsimi profesional, edhe arsimi parashkollor të kalojë në varësi të ministrisë që është përgjegjëse për arsimin. Vetëm kjo do t'i shërbente rritjes së cilësisë së arsimit, për mendimin e sindikatës.

Ne kemi kundërshtuar si të pabazuar në ligj portalin "Mësues për Shqipërinë" dhe, tashmë i provuar si i tillë, kërkojmë që ky portal, nga mënyra se si është zhvilluar në këto vite, ku të gjithë jemi dëshmitarë që shumë nga njësitë arsimore vendore kanë kryer punësime duke mosrespektuar portalin, mos të futet në ligj.

Nëse kërkohet vërtet të rritet cilësia e mësimdhënies, MASR-ja e ka shumë të thjeshtë: duke bërë publike rezultatet e provimit të shtetit dhe punësimi për mësuesit e rinj, të kryhet duke

respektuar renditjen në provimin e shtetit, i cili nuk është kundërshtuar nga askush deri më sot. Ishte një veprim shumë i domosdoshëm. Me futjen e profesionit të mësuesit te profesionet e rregulluara, ne, si sindikata, që kundërshtuam vetëm Urdhrin e Mësuesit si të papërshtatshëm për arsimin parauniversitar, ishim dakord me provimin e shtetit, sepse aty seleksionohen të gjithë ata që i blejnë diplomat e mësuesisë jashtë shtetit apo i marrin në mënyrë të padrejtë në universitetet brenda vendit. Provimi i shtetit, që është bërë mbas praktikës profesionale 1-vjeçare, nuk është kundërshtuar jo vetëm nga asnjë forcë politike, por nga asnjë individ, sepse përgjigjet merren aty.

Atëherë, le të bëhet edhe punësimi sipas renditjes në provimin e shtetit. Vetëm kështu ne mendojmë se do të jenë të interesuar të gjithë prindërit që sot ngurojnë t'i çojnë fëmijët e tyre për mësues, sepse nuk mund të gjejnë një vend pune. Vetëm kështu do të jenë të sigurt që, për fëmijët e tyre, që janë me rezultate të larta, do të respektohet meritokracia sipas rezultateve në provimin e shtetit, për të pasur një vend punë në arsim. Kjo do të nxiste të gjithë nxënësit me rezultate të larta. Për fat të keq, vitet e fundit të gjithë ata që shkojnë për mësuesi janë me rezultatet më të ulëta në të gjithë vendin.

Nga takimet që ne bëjmë në të gjitha rrethet e vendit, pyesim të gjithë kolegët tanë mësues: “Kush prej jush e ka çuar fëmijën për mësuesi?” Asnjë, as ne që jemi këtu. Asnjëri nga ne nuk i çon më fëmijët për mësuesi. Pse?

Ky duhet të jetë rezultati, me të cilin duhet të mburret Ministria e Arsimit sot dhe çdo ministri tjetër, çdo qeverisje tjetër që do të vijë, atëherë kur të gjithë ne, që jemi në këtë sallë dhe të gjithë ata që janë mësues, ashtu siç kanë qenë më parë breza mësuesish në familje: nëna, babai, djali, nipi, stërnipi, kur mësuesia të bëhet një profesion i kërkuar nga fëmijët tanë, kur t'i çojmë fëmijët atje dhe të mos i çojmë për mjekësi, për drejtësi, për informatikë dhe në shkolla të tjera.

Por që të bëhet kjo, duhet më shumë buxhet, duhen më shumë paga për arsimin dhe duhet që ata që shkojnë për të studiuar për mësuesi, ta kenë të sigurt vendin e punës.

Ne mendojmë dhe kërkojmë me këmbëngulje që për punësimin në arsim të respektohet renditja sipas rezultateve të provimit të shtetit. Në këndvështrimin tonë, kjo është më e sakta dhe më e mira.

Te neni 25 i projektligjit kërkojmë të përcaktohen institucionet e varësisë, sepse në projektligj thuhet se neni 30 shfuqizohet.

Neni 30 i ligjit “Për arsimin parauniversitar” ka të bëjë me njësitë arsimore vendore, si dhe me të drejtat dhe kompetencat e tyre. Tani ky nen është shfuqizuar.

Te neni 25, institucionet e varësisë përcaktohen me VKM. Pse duhet të kalojnë në një dorë të dytë, me VKM, institucionet e varësisë? Të jenë të përcaktuara në ligj, ashtu siç ishin në ligjin e mëparshëm, i cili është miratuar me 134 vota, pa asnjë votë kundër dhe pa asnjë abstenim. Të jenë të përcaktuara përsëri institucionet e varësisë.

Le të krijohen institucionet e varësisë sipas strukturave të Bashkimit European, në përshtatje me to, por të jenë të përcaktuara me ligj dhe t'i ngelen qeverisë të gjitha kompetencat e tjera, ashtu siç i ka pasur përpara, që mund t'i rregullojë me VKM ose me aktet nënligjore që nxjerr ministrja e Arsimit.

Te neni 31, “Këshilli vendor i arsimit parauniversitar”, pika 2, në fund të paragrafit të parë të shtohet: “Këshilli vendor i arsimit parauniversitar kryesohet nga kryetari i këshillit të qarkut dhe përbehet nga përfaqësues të qeverisjes vendore, personalitete të njohura për kontribute në fushën e arsimit dhe nga 2 përfaqësues nga partnerët socialë të çdo njësie arsimore vendore.” Nuk i gjen asnjë e keqe organet këshillimore, nëse brenda tyre ka anëtarë, qoftë edhe monitorues të partnerëve socialë.

Te neni 58, pika 6: “Burimet financiare për trajnimet e detyrueshme për rritjen profesionale përballohen nga buxheti i shtetit, projekte të organizatave jofitimprurëse, fondacione vendase dhe të huaja dhe burime të tjera të ligjshme”, kërkojmë të hiqet pjesa “nga kontributi vetjak”. Jemi në arsimin e detyrueshëm, në arsimin parauniversitar, që është falas për të gjithë. Atëherë, për të gjithë mësuesit, për mendimin tonë si sindikatë, trajnimin duhet ta marrë përsipër shteti.

Le t'u referohemi përsëri vendeve të rajonit.

Çfarë ka bërë Maqedonia dhe Kosova për mësuesit? I ka trajnuar ata edhe për të përdorur teknologjinë bashkëkohore. Maqedonia i ka trajnuar tërësisht, por edhe Kosova, në dijeninë time, si dhe nga kontaktet që kemi me sindikatën homologe në Kosovë, i ka trajnuar të gjithë mësuesit për të përdorur teknologjinë bashkëkohore.

Vetëm kështu mund të presim rezultate cilësore në mësimdhënie dhe mund të shmangen të gjitha problemet që hasen në përditshmëri me trajnimet e mësuesve, ku agjenci të licencuara, me çanta në duar, shesin kredite, që nuk i hyjnë në punë askujt.

Le të bëhet ajo pjesë që është e përcaktuar te neni 58, i ligjit nr. 69/2012, ku për jo më pak se tri ditë shteti merr përsipër trajnimin e mësuesve dhe ky trajnim duhet të jetë falas për të gjithë mësuesit, nëse duam vërtetë arsim dhe cilësi në mësimdhënie.

Në lidhje me shkollën e drejtorëve ka një shpjegim të paplotë mbi mandatin, statusin dhe kompetencat e shkollës. Detyrat ngarkuar drejtorit të shkollës, jo domosdoshmërisht kanë nevojë për krijimin e një shkolle drejtorësh, kur ata mund të perfeksionohen nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme, siç parashikohet në ligj. Nuk ka një domosdoshmëri reale për krijimin e një shkolle drejtorësh. Kjo është e zgjidhur nga mësuesit që kanë kryer programet master për menaxhim arsimi.

Atëherë, nëse një drejtor ka kryer programin master për menaxhim arsimi dhe sot është drejtor i një institucioni arsimor, i një shkolle, duhet të qëndrojë në pozicionin që është, pasi ka mbaruar një master, që për mua është shumë më i vlefshëm se një kurs ose një shkollë drejtorësh.

Sipas asaj që është parashikuar në ligj këta persona, në një të ardhme, duhet të lënë vendet e punës për t'ua lënë detyrën e drejtorit atyre që kanë mbaruar shkollën e drejtorit. Ne e shikojmë këtë si të panevojshme.

Ajo që kërkojmë, e kemi kërkuar edhe kur është hartuar ligji, në vitin 2012, por nuk është dëgjuar fjala jonë, përsëri sot, meqë është rasti kur po bëhen ndryshime në ligj... A duam të gjithë arsim cilësor, siç pretendojmë ne, ministria, prindërit dhe nxënësit? Po. Atëherë, si është më mirë? Të drejtohet shkolla nga një mësues specialist që ka mbi 10 vjet punë, apo nga një mësues që ka 5 vjet punë, siç është në ligj?

Kërkuam atëherë që, të jesh drejtor shkolle duhet të kesh të paktën 10 vjet vjetërsi pune. Kjo është në interes të të gjithëve. Shpresoj që ju ta merrni në konsideratë.

Neni 9. “Cili është institucioni arsimor vendor dhe cilat janë kompetencat e tij?” Kompetencat përcaktohen me ligj dhe jo me VKM, e thashë, siç ka qenë te neni 30.

Kishim edhe dy të kërkesa të tjera, që sot janë shqetësuese për mësuesit.

Personeli mësimdhënës, që nuk është i punësuar dhe ka mbaruar një shkollë të mesme pedagogjike ose një shkollë tjetër të profilizuar për mësuesi, siç është parashikuar te neni 72, pika 5, siç janë: shkollat e mesme të muzikës, artistike, të gjuhëve të huaja, të fizkulturës dhe që kanë fituar të tria shkallët e kualifikimit, kanë të drejtë të konkurrojnë

Të vendoset me ligj, sepse të gjithë ata mësues, që për arsye të ndryshme nuk ndodhen në Shqipëri në atë moment ose janë jashtë sistemit për mësues, por i kanë të tria shkallët e kualifikimit, nuk lejohen të hyjnë në portalin “Mësues për Shqipërinë” dhe nuk u jepet mundësia për t’u punësuar, ndërsa për pjesën që janë në sistem lejohet të hyjnë në portalin “Mësues për Shqipërinë”.

Mësuesit e kulturës së përgjithshme, të punësuar tek institucionet e arsimit dhe formimit profesional, kanë të drejtë të trajtohen me lëvizje paralele, sipas udhëzimit nr. 38 të MAS, në çdo shkollë tjetër joprofesionale, sepse mësuesve që janë në shkolla profesionale, tashmë kjo i drejtë u mohohet dhe ata ngelen gjithë jetën e tyre aty ku janë punësuar në fillim dhe janë të përjashtuar nga ky kriter, që është përcaktuar në udhëzimin nr. 38.

Ju falënderoj për vëmendjen!

Albana Vokshi – Faleminderit, zoti Kaptelli!

Zoti Nikollaj nga Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë.

Do t'ju lutesha, me kërkesë edhe të deputetëve, t'i përmbledhim në maksimumi 5 minuta fjalimet apo çështje që do të ngrini, në mënyrë që të marrim kohë për pyetjet dhe përgjigjet!

Faleminderit!

Kol Nikollaj – Ju falënderoj për ftesën në këtë event të rëndësishëm!

Normalisht, ne jemi mësuar me këto ndryshimet ligjore dhe tashmë na janë bërë rutinë. Ndoshta demokracia është në zhvillim, por ndoshta nuk ka edhe shumë përgjegjshmëri kur ndërmerren akte ligjore të një rëndësie të veçantë, sidomos për sa i përket aspektit të shërbimit publik, siç është çështja e arsimit.

Koha ka qenë e shkurtër, ashtu siç thatë edhe ju.

Nuk do të flas shumë gjatë, por dua të shpreh dakordësinë e Konfederatës së Shqipërisë për këtë ndryshim ligjor.

Sigurisht, gjatë gjithë këtyre viteve kemi ngritur probleme shqetësuese për Ministrinë e Arsimit, për sa i përket zbatueshmërisë ligjore, problemit të kakofonisë së akteve ligjore, nënligjore, udhëzimeve, ndryshimeve, të cilat, fatkeqësisht, kanë krijuar një pështjellim në sistemin arsimor, ndoshta e kanë dëmtuar edhe reformën që është ndërmarrë gjatë këtyre viteve.

Ne nuk kemi asnjë dyshim që ky ndryshim ligjor do të jetë në shërbim të arsimtarëve, të prindërve, të nxënësve, por kemi një dyshim tjetër, të cilin unë duhet ta shpreh para këtij komisioni kaq të rëndësishëm: me këtë administratë që ka Ministria e Arsimit, është e vështirë të zbatohen këto akte ligjore dhe nënligjore.

Gjej rastin t'i bëj edhe një herë thirrje Kryeministrit të vërë dorë në administratën e Ministrisë së Arsimit, e cila, në tërësi, lë për të dëshiruar për paaftësinë profesionale, mungesën e kapaciteteve, kryesisht për sa i përket problemit të marrëdhënieve të punës.

Po flas për këtë aspekt, sepse është fusha ku ne kemi direkt aktivitet, por siç edhe ju jeni dëshmitar, edhe në aspekte të tjera, administrata e Ministrisë së Arsimit vazhdimisht është shoqëruar me problematika.

Nuk është problemi se u harrua një numër rendor në një dëftesë apo u tërhoqën mësuesit nga pushimet për të shpërndarë dëftesat. Kjo nuk besoj se përbën ndonjë aspekt themelor shqetësimi, por shqetësimi ynë janë disa burokratë prej 20-26 vjetësh, të cilët qarkullojnë nëpër karrige dhe kanë ndryshuar gjithçka (nuk e di për familjet), qoftë bindjet, partinë, shkollën, diplomën, por fatkeqësisht nuk kanë ndryshuar pozicionin e punës në këtë ministri.

Edhe nga fjalët mjaft të vyera që përfaqësuesit e Bashkimit European thanë dje për Shqipërinë, besojmë dhe jemi të bindur (kur të doni ia argumentojmë edhe ministrisë, edhe juve, edhe qeverisë) që Ministria e Arsimit nuk mundet të plotësojë kriteret e Bashkimit European për të rregulluar marrëdhëniet e punës, pagës, shpërblimit, organizimit të punës, marrëdhëniet me sindikatat, me prindërit, me komunitetin, me pushtetin vendor, me të gjitha.

Nuk do të ndaloj shumë te problemi i ligjit.

Pjesërisht ndaj të njëjtat mendime me kolegët parafolës, por dua të shpreh kundërshtinë për sa i përket problemit të decentralizimit.

Besoj se tashmë të gjithë e kemi pranuar dhe jemi bashkudhëtar të asaj rryme, që pushteti duhet të decentralizohet dhe demokracia duhet të shkojë sa më afër qytetarëve. Po kështu, edhe arsimit parashkollor besoj se duke qenë pranë pushtetit vendor do të jetë shumë efikas, sepse pushteti vendor është qeliza, është kapilari më i afërt me komunitetin, me prindërit dhe me të gjithë.

Kështu, për sa i përket arsimit profesional besoj se largimi nga ajo ministri e burokratëve të arsimit ka dhënë frytet e veta. Normalisht, fatkeqësia ekziston, sepse u shkri Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, e cila kishte bërë një punë kolosale për sa u përket problemeve të arsimit dhe formimit profesional. Kalimi i saj në varësi të Ministrisë së Financave lë shumë për të dëshiruar për sa i përket këtij problemi. Ndoshta është ngadalësuar procesi i reformës në arsimin dhe formimin profesional, por ne jemi të bindur që nëse parlamenti dhe qeveria do të ndërhyjnë në strukturën apo organigramën qeverisëse, duke e rikthyer Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale, sigurisht që arsimit dhe formimi profesional shumë shpejt nuk do të ketë më 20% (nga 13%, sot kanë shkuar në 18 apo 20 % të nxënësve), por do të ketë rreth 40% dhe shumë shpejt ne si shtet do të kemi edhe kartën blu të arsimit dhe formimit profesional, duke i bërë profesionet tona të pranueshme në të gjithë BE-në.

Unë dua që fryma e bashkëpunimit dhe e konsultimit që ka ky komision, të shkojë te qeveria dhe te ministria përkatëse, si dhe te strukturat e tjera të pushtetit ekzekutiv, të cilat, fatkeqësisht, po ndjekin një politikë të faktit të kryer dhe nuk po ulen të bashkohen me aktorët dhe faktorët, dikush më shumë apo dikush më pak i rëndësishëm, por besoj se të gjithë jemi të vlefshëm në proceset demokratike.

Albana Vokshi – Faleminderit, zoti Nikollaj!

Fjalën e ka zoti Hajrush Çollaku, sekretar i Përgjithshëm i Federatës së Arsimit, Edukimit dhe Shkencës, anëtar i KSSH-së.

Hajrush Çollaku - Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar deputetë,

Megjithëse presidenti i shpalsi problemet e përgjithshme, unë dua të ndalem vetëm te lëvizja paralele e arsimit profesional. Mësuesit që u morën me bërjen e reformës së arsimit të përgjithshëm, ngelen aty, sepse nuk lejohet lëvizja e mësuesve të arsimit profesional të lëndëve të përgjithshme në MASR. Të paktën, nga përgjigjja që kemi marrë nga MASR-ja në atë kohë ka qenë se e vetmja pengesë është se ata nuk kanë kaluar një testim, në mënyrë që të rishikoheshin dijet e tyre dhe më vonë doli një testim shumë i rëndësishëm se kush nuk e kishte kaluar e të tjera me radhë, kurse sot ekziston ende problemi që mësuesit e arsimit profesional nuk lejohen që të futen në lëvizjen paralele, por duhet të futen në portalin “Mësues për Shqipërinë”.

Ndoshta ne e kemi pranuar që portali “Mësues për Shqipërinë” ishte diçka e mirë, që do të largonte mësuesit nga kryetarët e partive apo deputetët për ndërhyrje në arsim, por deri diku duhet të jetë më transparent, sepse sot e kësaj dite shikohet, të paktën, ankesat që kemi dëgjuar ne për mësues që mezi kanë kaluar kufirin minimal dhe janë futur shumë herë më përpara në arsim ose në sistem sesa ata që kanë qenë të parët në renditje.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit!

Fjalën e ka zonja Albana Mustafaraj nga Koalicioni për Arsimin në Shqipëri.

Albana Mustafaraj - Përhëndetje të gjithëve!

Shkurtimisht, Koalicioni për Arsimin në Shqipëri ka bërë disa rekomandime për këtë projektligj dhe disa ndryshime për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë. Nëse doni, unë mund t’i lexoj të gjitha një e nga një, por mendoj se është humbje kohe, sepse të gjithë deputetët i kanë para këto ndryshime.

Unë doja të theksoja vetëm një gjë: të gjitha rekomandimet që ka bërë Koalicioni për Arsimin në Shqipëri kanë pasur në fokus shërbimin psiko-social që duhet të ketë çdo institucion arsimor në Shqipëri.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit, zonja Albana Mustafarai!

Shezai Rrokaj - A mund të bëj një pyetje?

Albana Vokshi – Po, tani do të kalojmë te pyetjet.

Nga Fondacioni Shqiptaro – Amerikan për Zhvillim do të flasë ndokush, apo jeni vetëm si dëgjues?

(Diskutime pa mikrofon.)

Nga qendra “Për arsimin cilësor”, kush e do fjalën?

Po, zonja Dina.

Lirie Dina - Përshëndetje!

E nderuara zonja kryetare,

Të nderuar deputetë, faleminderit për ftesën për të qenë të pranishëm në këtë seancë dëgjimore!

Po paraqes në mënyrë koncize rekomandimet tona në lidhje me projektligjin për ndryshimin në ligjin nr. 69/2012.

Duke parë që në praktikë zbatimi i ligjit “Për sistemin arsimor parauniversitar” ka nxjerrë disa problematika, në jemi fokusuar dhe kemi hartuar disa propozime.

Më konkretisht, në nenin 20 “Shërbimi psiko-social në institucionet arsimore”, ne propozojmë të shtohet edhe raporti psikolog – punonjës social për nxënësit. Është i nevojshëm parashikimi i një raporti të tillë, sepse në vlerësimin tonë duhet të ketë një psikolog ose një punonjës social për 600 nxënës, me qëllim planifikimin e mjeteve financiare dhe burimeve njerëzore nga Ministria përgjegjëse e Arsimit, si dhe për rritjen e standardeve psiko-sociale.

Gjithashtu, në nenin 25 “Funksionet kryesore të ministrisë”, ne mendojmë se duhet të shtohet edhe një funksion tjetër, i cili ka të bëjë me hartimin dhe me zbatimin e politikave gjithëpërfshirëse për integrimin e personave me nevoja të veçanta.

Në nenin 28 “Njësia bazë e qeverisjes vendore”, ne propozojmë që të bëhet një riformulim në germën “b”, brenda së cilës të përcaktohet në mënyrë të shprehur detyrimi i financimit të

sigurisë fizike të nxënësve dhe të institucioneve arsimore në juridiksionin e tyre të njësive të qeverisjes vendore.

Ne propozojmë këtë formulim: “Garantimi i sigurisë fizike të nxënësve në institucionet arsimore, paprekshmëria e institucioneve arsimore në juridiksionin e saj, si dhe i mjediseve të tyre”, duke parë edhe problemin e madh që ekziston në praktikë për garantimin e sigurisë së ambienteve, ku në pjesën më të madhe të rasteve janë prindërit ata që financojnë për sigurimin e ambienteve të shkollës.

Në pikën 2 të nenit 28, të shtohet germa “d” me këtë përmbajtje: “Ofrimi i shërbimeve dhe mbështetja e fëmijëve me aftësi të kufizuara”. Gjithashtu, në nenin 28 të shtohet një pikë 5 me këtë përmbajtje: “Njësia bazë e qeverisjes vendore siguron dhe financon transportin për nxënësit me aftësi të kufizuara dhe për nxënësit, që jetojnë jashtë zonave të mbulimit të shkollave, për të zvogëluar braktisjen e shkollës dhe për të nxitur ndjekjen e vazhdueshme të saj”.

Në lidhje me nenin 63 “Parime të arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara”, në pikën 3, përveç asaj që është parashikuar nga ministria, propozojmë që këtij formulimi t’i shtohen fjalët: “Nxënësve me aftësi të kufizuara, që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore dhe intelektuale, t’u garantohet pajisja me mjete didaktike dhe ndihmëse sipas nevojave individuale.”

Në nenin 65 “Organizimi i arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara” me qëllim që të ndihmohet planifikimi financiar dhe i burimeve njerëzore, në funksion të zbatimit të këtij neni, pika 3, sugjerojmë që ligji të parashikojë raportin mësues ndihmës - nxënës me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, sugjerojmë që në ligj të shprehet në mënyrë të qartë: “Ministria përgjegjëse e Arsimit në hartimin e buxhetit për arsimin, të parashikojë financim të veçantë në mbështetje të arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara, të cilët frekuentojnë institucionet arsimore të zakonshme publike.”

Faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit!

Fondacioni Shqiptaro – Amerikan për Zhvillim ka shprehur vetëm interesin për të dëgjuar, apo jo?

Faleminderit!

Atëherë, mbaruam me dëgjesa! Tani do të kalojmë te pyetjet.

Po, profesor.

Shezai Rrokaj – Meqenëse këtu ka të ftuar nga Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, pyetja ime lidhet me faktin: a jeni ju në dijeni të draftit të fundit? A lidhen rekomandimet tuaja me draftin e fundit që po diskutojmë? A i keni çuar këto rekomandime në ministri dhe çfarë *feedback*-u keni marrë prej saj? Pra, ne po kalojmë një draft dhe rekomandimet tuaja mund të jenë edhe të tërthorta, por mund të jenë edhe jashtë draftit, ndaj dua të di nëse ju keni dërguar rekomandime me shkrim në ministri për këtë draft. Nga shqyrtimi i draftit që keni para, a janë marrë apo jo parasysh rekomandimet që ju keni nënshkruar? Nuk e di a jam i qartë, apo jo?

Albana Vokshi – Kush ka pyetje të tjera, në mënyrë që t'i mbledhim dy-tre pyetje nëse ka?

Po, zoti Boçi.

Luçiano Boçi – Faleminderit!

Meqenëse nuk isha prezent në dëgjuesën e Sindikatës së Pavarur të Arsimitarëve, e lexova materialin me vëmendje. Përfaqësuesit e sindikatave, të cilët janë të pranishëm këtu, kanë qenë pjesë e nënshkrimit të kontratës kolektive të punës për mësuesit, e cila më në fund arriti të miratohet nga Ministria e Arsimit pas një maratone të gjatë, duke notuar prej një viti në një shtrat antiligjor, siç është bërë edhe me pika të ndryshme të ligjit “Për arsimin parauniversitar”, që ne i evidentuam dje në opionencën që i bëmë në parim ndryshimeve ligjore të sjella nga ministria.

Në lidhje me kontratën që unë evidentova, kam një pyetje për sindikatat. Në këto ndryshime ligjore, pavarësisht faktit nëse ju kanë thirrur ose jo për konsultime, sepse këtë pyetje e bëri zoti Shezai dhe unë nuk dua ta përsëris, a e gjeni veten ju, si sindikata, në terma ligjorë? A përputhet kontrata kolektive e punës me ndryshimet përkatëse? Sepse ndryshimet themelore që unë shikoj dhe që duhet të jenë në përputhje me kontratën kolektive të punës janë pikërisht krijimi i Këshillit Kombëtar të Arsimit dhe sidomos çështja e pozicionit të artificës së drejtorëve të shkollave, të cilët do të dalin jo nëpërmjet formimit profesional universitar, por nga një shkollë “partie”, sepse nga partia do të dalin realisht, pavarësisht pjesës zbukuruese që paraqitet në ligj e të tjerë. Ju nuk keni kundërshti për këtë, sepse kontrata duhet të parashikojë edhe kompetencat e drejtorit, por edhe raportin që ai duhet të ketë me punëdhënien dhe me shkarkimet nga puna të mësuesve, sepse shikoj që ka mospërputhje.

Në lidhje me kontratën, ju keni shprehur në relacionin tuaj kundërtinë për portalin “Mësues për Shqipërinë”, i cili ka funksionuar sipas orientimeve politike dhe jo sipas parimeve mbi të cilat është ndërtuar. Ne e kemi kundërshtuar këtë portal dhe jemi shprehur se ka qenë antiligjore

përderisa tani kërkohet që të futet në ligj. Nëse kërkohet të futet në ligj dhe portali ka të bëjë me procedurën e emërimit të mësuesit, ju, si sindikatë, si e shikoni procedurën e emërimit, që është shumë e gjatë dhe procedurën e pezullimit, që stopon tërësisht me procedurën e emërimit, sepse procedura e emërimit nuk i jep asnjë status mësuesit, ndërkohë për ta pezulluar atë mjafton që drejtori i shkollës ta largojë nga shkolla. Pra, si është balanca ndërmjet emërimit që kryhet nëpërmjet një kalvari të gjatë për mësuesit, që, pas këtij kalvari patjetër duhet të ketë status të mbrojtur nga sindikata, dhe në fund është drejtori i shkollës, që me një kod etike të thjeshtë, duke nxitur një konflikt banal, mund ta pushojë nga puna mësuesin kur të dojë; mund t'ia heqë orët e punës dhe ta kalojë me kontratë dhe pas një viti ta largojë fare nga sistemi. Pra, si i shihni këto kundërshti brenda kontratës kolektive të punës dhe ndryshimeve ligjore? Kjo është ajo për të cilën sindikata duhet patjetër të angazhohet, të marrë përgjegjësi dhe të propozojë ndryshime konkrete bazuar në ndryshimet që ka sjellë Ministria e Arsimit.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit!

Nevrus Kaptelli - Unë dua t'i përgjigjem fillimisht pyetjeve të profesor Rrokaj, nëse na është paraqitur draftprojektligji nga Ministria e Arsimit për ta studiuar dhe për të dhënë mendimet tona.

Unë e thashë që ndoshta ka qenë e kuptueshme, që për herë të parë Ministria e Arsimit, për hir të së vërtetës, na ftoi për të dhënë mendime për ndryshime në ligjin e arsimit parauniversitar, por ajo që është bërë nga ministria ka qenë formale.

Njoftimi ka qenë i tillë: “Ministria e Arsimit do të ndërmarrë nismën për ndryshime në ligjin e arsimit parauniversitar dhe ne kërkojmë që ju të na paraqisni propozimet tuaja”. Ne nuk kemi pasur një draft të projektligjit edhe pasi është bërë ky njoftim. Këtë draft ne e kemi parë dje pasdite nga zoti Muhamet, pas kërkesës së bërë nga ne. Ministria na ka kërkuar ndryshimet dhe ne mblodhëm komisionin tonë të sindikatës dhe e shtjelluam ligjin, duke nisur nga neni 1, se çfarë mendonim ne që duhej ndryshuar. Këto i kemi dërguar në ministri dhe një pjesë e tyre, që kishin të bënin me ndryshimet e qeverisjes vendore, siç e thashë, janë parashikuar, kurse pjesa tjetër nuk ka qenë. Nuk e di nëse jam i qartë në përgjigje.

Albana Vokshi – Domethënë, nuk ka kaluar në procedurat e konsultimit publik, ashtu sikurse e përmban legjislacioni përkatës?!

Nevrus Kaptelli - Do të ishte normale që ministria ato çfarë kishte parashikuar, të na i jepte neve, duke thënë: ne kemi menduar të bëjmë këto ndryshime. Pra, nuk e kemi pasur.

Milva Ekonomi – A mund të bëj një pyetje?

Luçiano Boçi - Prisni të marrim ne përgjigjet për pyetjet tona.

Miva Ekonomi – I mora leje kryetares për këtë gjë.

Ne të gjithë e dimë që konsultimet publike, përveç takimeve, zhvillohen edhe online.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Një minutë, sepse dua t'ju them diçka! Ndërkohë që një projektligj hartohet, në faqen zyrtare të internetit të çdo ministrie ka një hapësirë të veçantë ku depozitohet projektligji për të dhënë mendime. Në rastin e këtij projektligji, ne kemi parë që ministria e ka bërë këtë detyrë. Domethënë në qoftë se ju mund të shkoni te faqja e ministrisë, që besoj se e bëni gjithmonë, sepse keni interes për të parë se çfarë po ndryshohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në aktet administrative dhe në urdhrat e brendshme, pra do të shihni që ky projektligj ka qenë në portal. Ndoshta edhe vetë sindikata duhet ta kishte parë nëse janë marrë në konsideratë apo nuk janë marrë, sepse ju keni depozituar dhe është marrë mendimi juaj. Mendimet mund të mos merren të gjitha parasysh, sepse duhet parë edhe logjika e ligjit për të marrë në konsideratë ato që keni parashtruar ju.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Por unë do t'ju lutesha që të shikoni edhe *web-in* e ministrisë për projektligjet që depozitohen, për konsultime.

Albana Vokshi – Ka një ligj për konsultimin publik, i cili përcakton shumë qartë se si bëhet konsultimi i një projektligji. Pra, ka edhe pjesën online, ka edhe takimet. Pse duhet të mënjanohen takimet, sepse ato janë aktorët kryesorë të interesit? Nëse nuk u takuan konfederata, federata, sindikata...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk ka qenë, sepse e kanë bërë para disa muajve, kur u kanë thënë se do të hartonin një projektligj.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Një sekondë se po flas unë!

Atëherë, kërkojuni më mirë palëve të interesit që të futen te portali *Shqipëria që duam.com* dhe për 3 minuta ju e keni të zgjidhur problemin tuaj dhe rrëzojini të gjitha ligjet, sepse ju këtë po

thoni. Keni ligjin e konsultimit publik, i cili nuk zbatohet absolutisht nga asnjë institucion i qeverisë. Minimalja që mund të bëhet me palët e interesit është të dëgjohen, të konsultohen, t'u merren mendimet, sepse specialistët më të mirë janë te palët e interesit. Kjo gjë nuk është bërë dhe tani do të mundohemi që komentet që na keni sjellë, të mundemi maksimalisht, nëse është edhe dëshira e maxhorancës, t'i përfshijmë në këtë ligj.

Nevrus Kaptelli - Përgjigja ime për zëvendëskryetaren është e thjeshtë. Ne e kishim këtë projektligj edhe në faqen e Kuvendit, atëherë pse na thirrët këtu?

Albana Vokshi – Sepse komisionet e Kuvendit veprojnë ndryshe nga qeveria.

Nevrus Kaptelli - Ne këtë kërkojmë edhe nga Ministria e Arsimit, asgjë më tepër, sepse duket që është konsumuar. Profesori pyeti nëse ne ishim njohur apo jo me projektligjin. Ne nuk kishim një projektligj, por na thanë: “Ligji do të ndryshohet, por ne duam një herë edhe mendimet tuaja”. Ne punuam me të gjithë ligjin në komisionin e ngritur nga ana jonë. E mira do të ishte që të dinim se cilat nene propozoheshin nga ministria për t'u ndryshuar dhe të jepnim mendimin tonë si partnerë socialë. Megjithatë, unë e quaj të ezauruar këtë përgjigje, ndaj po kaloj te pyetjet e zotit Boçi.

A përputhen kontratat kolektive me ndryshimet përkatëse që parashikohen në këtë projektligj?

Për hir të së vërtetës, ne kemi zhvilluar negociata të gjata me Ministrinë e Arsimit, e cila për herë të parë ka qenë e interesuar që në kontratën kolektive, që ne kemi nënshkruar me Ministrinë e Arsimit në datën 5 qershor, të merrnim parasysh edhe ndryshimet që mund t'i bëheshin ligjit të arsimit parauniversitar. Pjesa më e madhe e tyre janë parashikuar në kontratën që është nënshkruar, ashtu siç ishte edhe ajo që unë përmenda pak më parë, për strukturimin e njësive arsimore vendore. Ne kemi marrë masat për diçka tjetër: edhe punëdhënësit, edhe ne, pra kemi vendosur një nen në kontratë, që me gjithë ndryshimet, të cilat mund të ndodhin nga ndryshimi i ligjit, palët mund të ulen dhe të bëjnë aneks kontrate, ku të pasqyrohen të gjitha ndryshimet, duke u përshtatur në ligj dhe në kontratën kolektive.

Lidhur me drejtorët e shkollave, zoti Boçi, unë e shpjegova me gojë që ne, si sindikatë, nuk jemi dakord për shkollën e drejtorëve. Ne e kemi dhënë mendimin tonë edhe në medie, edhe në ministri, e thashë edhe pak minuta më parë këtu që për ne deri më sot nuk ka një institucion më të pakundërshtuar se provimi i shtetit. Edhe nëse nesër do të jetë tjetër qeveri, do të jetë tjetër forcë politike, ne përsëri këtë qëndrim do të mbajmë. A doni që arsimi të bëhet profesion i dëshiruar për

të gjithë nxënësit me rezultate të mira? A dëshironi që prindërit t'i çojnë fëmijët e tyre për mësuesi? Sot në Shqipëri nuk gjen asnjë mësues që ta çojë fëmijën e tij për mësuesi. Atëherë nëse doni, rrisni buxhetin për arsimin më shumë se 5%; rrisni pagat e mësuesit dhe krijojuni mundësinë prindërve dhe nxënësve që më i miri të punësohet. Atëherë, bëjeni punësimin pa portalin “Mësues për Shqipërinë”; Ministria e Arsimit të bëjë publike rezultatet e arritura në provimin e shtetit pas praktikës profesionale, për shembull: Luçiano Boçi është me notën 10 në Gjuhë-Letërsi dhe ka të drejtën i pari të punësohet në vendin e parë që lirohet e me radhë të tjerët. Atëherë çdo prind do të shikojë në mënyrë transparente, në internet, që është krijuar një vend dhe fëmija i tij do të punësohet e kështu me radhë. Duke pasur paga më të larta, duke pasur një punësim sipas meritës, sipas rezultateve të arritura në provimin e shtetit, atëherë nxitet interesi i mësuesve për t'i çuar fëmijët e tyre për të studiuar për mësuesi.

Lidhur me shkarkimin e mësuesve apo drejtorit të shkollës, mund të them se nuk jemi marrë shumë me drejtorët e shkollave në kontratën kolektive, për arsyen e thjeshtë se në ligjin nr. 69/2012 drejtori i shkollës është në rolin e punëdhënësit, por asnjëherë nuk ka qenë jashtë vëmendjes së sindikatave tona, edhe të SPASH-it edhe të FSASH-it. Ne jemi prononcuar dhe kemi mbajtur qëndrimet tona edhe në kohën kur mësuesit u përdorën për të dhënë vlerësimet e tyre për drejtorin në kundërshtim me ligjin. Pra, drejtori vendosej sipas kritereve të përcaktuara në ligj dhe merrej mendimi i mësuesve: a e doni më këtë drejtor, apo jo? Çdo veprim që merret nga Ministria e Arsimit apo nga kushdo tjetër, në kundërshtim me ligjin dhe me aktet nënligjore për ne është i papranueshëm dhe është një tallje me dinjitetin e mësuesve dhe drejtorëve apo me këdo tjetër që është pjesë e arsimit parauniversitar. Ne, ashtu siç kemi denoncuar këto gjëra në kohë, të njëjtin qëndrim do të mbajmë edhe kur të konstatojmë qëndrime të tjera, që janë në kundërshtim jo vetëm të mësuesve, por edhe të drejtorëve, pavarësisht se ata janë në rolin e punëdhënësve.

(Drejtimit e komisionit e merr nënkryetarja e komisionit, zonja Milva Ekonomi.)

Milva Ekonomi – A dëshiron dikush tjetër nga të ftuarit t'u përgjigjet pyetjeve?

Novruz Kaptelli - Falënderoj të dy profesorët për pyetjet shumë interesante!

Ndoshta mund të dal nga tema, por unë do të flas shumë shkurt.

Për sa i përket problemit të konsultimit, ne si sindikatë as nuk jemi thirrur dhe as nuk jemi konsultuar. Sindikata që unë drejtoj, sot për sot është sindikata më e përfaqësuar në Shqipëri dhe ka pesë anëtarë në Këshillin Kombëtarë të Punës, ku edhe Ministria e Arsimit është anëtare si palë e qeverisë. Ky ligj, normalisht, duhet të kishte kaluar në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe

me Kodin e Punës. Të gjitha ligjet që kanë aspekte publike, sociale, të shëndetësisë dhe arsimit, duhet të kalojnë në Këshillin Kombëtar të Punës para se të vijnë në qeveri dhe në parlament. Fatkeqësisht, ky ligj nuk ka kaluar në Këshillin Kombëtar të Punës.

Për sa i takon kontratës kolektive, nuk dua që të sjell konfliktin e ministrive me sindikatat në këtë parlament të nderuar, por dua t'ju informoj se kontrata e para 2 vjetëve ka qenë e pavlefshme me vendim të Gjykatës Administrative të Tiranës. Fatkeqësisht, edhe kontrata e re, që është nënshkruar, është absolutisht e pavlefshme dhe shumë shpejt do ta dëgjoni edhe me vendim gjykatë, por do të shtyhet pak në kohë, sepse që nga marsi i muaji të kaluar të gjitha konfliktet gjyqësore që zgjidhjen e tyre e gjejnë në Kodin Punës kanë kaluar përsëri në Gjykatën Civile, e cila ka disa procedura më të zgjatura. Konfederata e Sindikatave nuk mund të nënshkruajë një kontratë ku thuhet: 50% e punonjësve që janë roje shkollash janë informalë dhe nuk paguajnë sigurime shoqërore; nuk mund të nënshkruajmë një kontratë ku gjysmës së mësuesve në Shqipëri nuk u garantohej transporti në shkolla dhe nuk u paguhet vështirësia kur shkojnë në punë; nuk mund të nënshkruajmë një kontratë ku asnjë mësues nuk ruhet nga ligji për sigurimin e shëndetit në punë, nuk ruhet nga ligji për antidiskriminimin, nuk konsultohet për pagat, për buxhetin e të tjera me rradhë. Këto janë probleme që nuk i përkasin këtij komisioni, por komisioni duhet të informohet, dhe unë gjeta rastin ta informoj. Mirë është që edhe ministrat që vijnë në këtë komision të informohen për këto probleme, sepse ne shumë shpejt do të marrim miliona lekë si dëmshpërblim për dy vjet, kjo e shkaktuar nga kontrata e shfuqizuar si e pavlefshme nga Gjykata Administrative dhe këto lekë do të merren nga buxheti i shtetit, sepse nuk paguhen as nga ministri, as nga unë dhe as nga ju, siç janë paguar edhe shumë mësues që janë larguar nga puna kur kanë humbur të drejtat e tyre në mënyrë antiligjore.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Faleminderit!

Romeo Gurakuqi – Unë kam një pyetje për përfaqësuesit e Fondacionit Shqiptaro–Amerikan për Zhvillim, për zonjën Leskaj dhe Lamaj. 2.9 milionë dollarë keni akorduar ose do t'i akordoni për shkollën e drejtorëve, por dua t'ju them se Shqipëria nuk vuan nga mospasja e kapaciteteve drejtuese në sistemin arsimor, por përgjithësisht prej kohësh që nuk mbahen mend, vuan nga vendosja e tyre në drejtim dhe praktikisht nga politizimi i sistemit të drejtimit. A gjykoni ju se është më e përshtatshme, përpara se të merreni me çimentimin e sistemit aktual të drejtimit të arsimit të lartë në këtë instancë të politizuar, ta adresoni këtë fond prej 2,9 milionë dollarësh për

ndërtimin e terreneve sportive për fëmijët shqiptarë, që vuajnë nga mospasja e këtyre terreneve? Kjo është pyetja e parë.

Pyetja dytë u drejtohet përfaqësuesve të sindikatave. Disa prej parimeve që duheshin mishëruar qartë në ligj dhe një listë prioritetesh do të duhej të ishin: profesionalizmi, financimi më i madh i arsimit të lartë, depolitizimi total i arsimit, aftësia si kriter bazë, thjeshtësia e sistemit, trajnimi i mësuesve me programe adekuate, rritja e pagave të sistemit, pagesa e posaçme e studentëve që shkollohen në pedagogji, pra në sistemin arsimor, posaçërisht në shkencat e natyrës, dhe rritja e terreneve sportive. A mendoni ju që këto ndryshime ligjore që na sillen këtu e ndalojnë dekadencën e profesionit të mësuesit, vendosin profesionalizmin në drejtim, izolojnë dhe përjashtojnë politizimin?

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Faleminderit, zoti Romeo!

Kush nga përfaqësuesit e Fondacionit Shqiptaro–Amerikan do të përgjigjet?

Ekflodia Leskaj – Përshëndetje!

Për sa i përket fondit prej 2,9 milionë dollarësh, Fondacioni Shqiptaro–Amerikan për Zhvillim operon mbi bazën e projekteve të ndryshme, të cilat akordohen nga bordi drejtues i vetë fondacionit. Ky ka qenë një projekt i parë në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, si një domosdoshmëri në një fushë dhe në një sektor ku vetë fondacioni ka një veprimtari të gjatë që operon. E parë edhe në bazë të nevojave, që drejtuesit aktual të institucionit të arsimit parauniversitar kanë, për sa u përket njohurive menaxheriale drejtuese dhe lidhshimit, është parë e arsyeshme që të krijohet një shkollë e tillë me një program, i cili mund të investojë më tepër në njohuritë praktike menaxheriale dhe jo ato teorike. Pa dyshim, nëse do të shikohet si një projekt më vete apo si një prioritet pjesa e fushave apo e veprimtarive të ndryshme sportive, natyrisht që në të ardhmen do të jetë një program më vete dhe mund të investohet edhe aty. Për momentin është parë ky si projekt, i cili është votuar dhe miratuar në bord dhe kemi ardhur edhe në këtë projektligj.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Ndonjë përfaqësues i sindikatave dëshiron t'i përgjigjet pyetjes së zotit Gurakuqi?

Nevruz Kaptelli – Pyetja ishte: A mendoni se ndryshimet në ligj largojnë dekadencën dhe politizimin e arsimit? Nuk e di nëse jam i saktë me pyetjen që bëtë, sepse e thjeshtëzova pak.

Ne e kemi thënë që këto ndryshime nuk largojnë as dekadencën dhe as politizimin e arsimit, sepse për ne nuk ka nevojë për shkollë drejtorësh sa lekë do të investojë Amerika. Ka hapësira të tjera ku mund të investohet në Shqipëri, sidomos për përmirësimin e cilësisë së arsimit, ambienteve shkollore dhe të gjitha kushtet e tjera të punës së mësueseve. Ne nuk kemi vuajtur për drejtues të aftë të shkollave; dy forcat e mëdha politike i kanë me shumicë. Meqenëse jeni duke e ndryshuar ligjin, bëjeni atë që thamë ne që të rritet niveli i drejtorëve, përse duhet të jetë drejtor Nevruzi me 5 vjet punë dhe jo Ariani që ka 10 vjet punë, pra nga mësues specialist, të vendoset që drejtori i shkollës duhet të jetë mësues mjeshër.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ta mbaroj.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ngaqë di më shumë. Ju vini nga rrethe të ndryshme dhe i keni të gjitha mundësitë të merrni si shembull rrethet nga vini dhe unë po marr Korçën, meqë e njoh mirë dhe kam pasur debate të forta kur ishte testimi i mësuesve për Shqipërinë. Më kujtohet një mësues, Ded Damianeci, i cili ishte drejtor i një shkolle në Korçë dhe m'u drejtua: "Zoti Kaptelli, çfarë po bëni, përse i lejoni të tallen me ne, unë edhe dy vjet dal në pension dhe duan të më testojnë nëse jam i aftë apo jo. Janë ata që i nxora nga shkolla dhe u bënë drejtorë arsimit në Korçë dhe një pjesë e tyre ka vajtur në ministri". Unë i thashë: "Zoti drejtor, a bën mbledhje me Kristaqin? Po drejtorët e tjerë a bëjnë? Përse nuk ia ngrini këto probleme drejtorit dhe t'i thoni se kush jeni ju që na merrni në testim?" Më falni se nuk doja të kaloja te testimi, sepse ajo është temë e mbyllur tashmë, por doja të tregoja që të dyja forcat politike kanë drejtues me eksperiencë të shkëlqyer, por çështja është se ulet steka dhe me ligj drejtori i shkollës zgjidhet po të ketë 5 vjet punë, pra u jepet mundësia atyre që kanë zë më të fortë në mitingje. Nëse doni ta ndryshoni këtë, propozojeni, sepse të gjithë jeni mësues, ngrijeni nivelin e drejtorit të shkollës në mënyrë që të jetë i përcaktuar me ligj. Ka kaq vite që në Shqipëri ekziston masteri për menaxhim arsimit, bëjini kriteret edhe më të forta, që drejtori i shkollës të ketë mbaruar mastër për menaxhim arsimit dhe nuk ka nevojë për këto shkolla. Këto shkolla u japin mundësi vetëm disave që...

Milva Ekonomi – A mund të na sugjerosh përgjigjen.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Luçiano Boçi – Ju lutem, lëreni të flasë!

Milva Ekonomi – Kam të drejtën ta drejtoj mbledhjen.

Luçiano Boçi – Keni të drejtë ta drejtoni dhe jo ta ndërprisni.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Përse shqetësoheni se flet ai? Nuk e kuptoj përse duhet ndërprerë!

Milva Ekonomi – Do t’ju lutesha shumë të fokusoheni te përgjigjja, sepse kemi edhe të ftuar të tjerë.

Nevruz Kaptelli – Për mendimin tonë si sindikatë e pavarur, ndryshimet në projektligj nuk e rregullojnë problemin e politizimit të arsimit dhe shkolla e drejtorëve i jep mundësi çdo force politike që të vendosë drejtorët e forcës së vet.

Milva Ekonomi – Fjalën e ka zoti Rrokaj.

Shezai Rrokaj – Faleminderit!

Kisha një pyetje për përfaqësuesit e Fondacionit Shqiptaro–Amerikan për Zhvillim. Duke i konsideruar si palë, nuk mendoja që ata të merrnin pjesë në këtë dëgjese. Për mendimin tim, është shumë i rëndësishëm fakti i të shprehurit në relacion dhe të fiksuarit në mënyrë të drejtpërdrejtë se kush do ta drejtojë këtë gjë. Do të kisha preferuar që në relacion të hiqet pjesëmarrja e Fondit Amerikano–Shqiptar për Zhvillim dhe këtë kompetencë ta ketë Ministria e Arsimit në bashkëpunim me universitetet që merren me mësuesinë. E them këtë, sepse ne kemi një traditë ndoshta jo të mirë dhe me defekte. Unë jam plotësisht dakord që të ketë një shkollë për drejtorë, por nuk jam dakord që të përjashtohen universitetet, sepse ata janë hartuesit e kurikulave. Për këtë ne kërkojmë mirëkuptim nga kolegët socialistë dhe mendoj që Fondi nuk ka ekskluzivitet përvojë në shkollën për drejtor, pra që merret vetëm me këtë punë. Po të kishte ekskluzivitet, do ta mirëkuptoja edhe arsyen.

Përveç kësaj, me sa kuptova nga ndërhyrja e parë e përfaqësuesve të Fondit, thanë që ky projekt ka qenë një kërkesë e ardhur nga ministria jonë. Natyrisht që edhe projekte mund të bëhen, por më shqetëson shumë natyra e ekspertizës së fundit, prandaj dua një përgjigje të qartë dhe të prerë, Fondi ku do t’i gjejë partnerët që do të merren me hartimin e kurikulës dhe me zbatimin e saj? E thënë më shqip, a do të bashkëpunojë Fondi me universitetet publike, sepse ka një kohë të gjatë që në arsim, Vilma mundet të ma konfirmojë, kemi edhe mastera të caktuara për menaxhim arsimi në Elbasan, në Durrës e kështu me rradhë.

Si duhet të jetë një drejtor, duhet të jetë edhe i natyrës menaxheriale apo i natyrës profesionale, sepse është një debat i madh se si duhet të jetë rektori: menaxher apo profesor? Unë jam i mendimit që duhet një njeri që të menaxhojë këto dy anë, edhe anën menaxheriale, por edhe

anën profesionale. Pyetja ime edhe një herë është kjo: Fondi ka ndërmend të bashkëpunojë me universitetet tona për ngritjen e kësaj shkolle dhe për pasojë ne të insistojmë që të vendoset në ligj fraza “në bashkëpunim me universitetet publike, që prodhojnë diploma për arsimin”, apo ka ndërmend të sjellë një përvojë amerikane, që kolegja Duka e tha dje, ku të jenë disa të huaj që vijnë për të ndërtuar këtë shkollë me kurikulat e tyre dhe jashtë realitetit shqiptar dhe të na krijohen disa drejtorë futurist jashtë kontekstit? Përgjigjen e dua për të qenë më të qartë ne dhe opinionin publik, sepse përjashtimi i universiteteve publike për arsimin, të cilët kanë edhe mastera që lidhen me menaxhimin, më duket një pabesi dhe një mungesë besimi ndaj shkollës sonë. Këto universitete mund të bashkëpunojnë me organizma amerikanë, patjetër le të vijnë dhe të bashkëpunojnë, por të ndërtohet një shkollë, ku përvoja dhe tradita shqiptare të gërshetohet me parametrat më të mirë të Amerikës dhe të Europës.

Milva Ekonomi – Që të vazhdojmë me këtë rend, do ia jap fjalën edhe zonjës Duka për një pyetje dhe pastaj t’ua kalojmë fjalën të ftuarve për përgjigjet. Besoj se ky është raundi i fundit i pyetjeve që kemi, sepse kemi të tjerë që po presin për dëgjuesë.

Valentina Duka – Mirëdita!

Kam një pyetje për përfaqësuesit e sindikatave: në Këshillin Kombëtar të Arsimit Parauniversitar, që rikompozohet sipas këtij ligji, ju mungoni, cili është mendimi juaj, sepse janë konsultuar me ligje të tjera të rajonit dhe më tej rajonit dhe nuk ka Këshill Kombëtar ku të mos ketë përfaqësues të sindikatave dhe të universiteteve, ndërsa ju këtu mungoni? Po t’i shikoni, ky këshill është i mbushur me burokratë, që sa herë ndryshon ministri i një force politike, për të mos thënë ministrat e forcave të tjera politike, ndryshojnë edhe burokratët që marrin pjesë në këta këshilla.

Cili është mendimi juaj?

Nevruz Kaptelli – Në nenin 2, pika 18, e ligjit nr. 69/2012 thuhet: “Sindikatat nënshkruese të kontratave kolektive janë partnerë socialë” pra kanë marrë këtë emër në ligj. Në nenin 26, germa “f”, dhe në ligjin për Këshillin Kombëtar të Arsimit ...

Milva Ekonomi – Më falni, por zoti Boçi do të bëjë edhe një pyetje dhe pastaj mund t’u përgjigjeni pyetjeve.

Luçiano Boçi – Pyetja ime është për përfaqësuesit e ministries. Ndoshta dikush mund të thotë se pyetjen duhet ta kishit bërë dje, por desha një përgjigje shumë konkrete, pasi edhe përgjigjet e djeshme nuk e ezauruan totalitetin e pyetjeve që bëmë. A është marrë opinionin i

Fakultetit të Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës në lidhje me shkollën e drejtorëve, sepse, në dijeninë time, ata janë deklaruar në një postim të tyre kundër hapjes së kësaj shkolle.

Milva Ekonomi – Kush e do fjalën për të dhënë përgjigje për pyetjet e bëra nga zoti Rrokaj, Duka dhe zotit Boçi?

Gentian Sejrani – Në lidhje me debatin për shkollën e drejtorëve, ndoshta do më duhet dy minuta kohë për të shpjeguar logjikën e krijimit të shkollës dhe debatit konstruktiv që kemi pasur me fakultetet e shkencave sociale në Tiranë ose edhe me fakultete të tjera të edukimit. Teknikisht, zhvillimi profesional i referohet zhvillimit në vazhdim, ku pjesë e pandarë e zhvillimit profesional janë edhe drejtuesit e shkollave. Ka pasur disa tentativa, njëri nga deputetët përmendi rastin e Fierit, në vitin 2009 ka pasur një program për zhvillimin profesional të drejtuesve në Ministrinë e Arsimit në bashkëpunim me IAL-të, ku formohen mësues, i cili i shkruar në letër ishte shumë i mirë, por nuk u aplikua kurrë në terren. Më pas në të gjitha konsultat që ne kemi pasur me partnerët ndërkombëtarë, kur implementuam fillimin e reformës parauniversitar, u rekomandua një strukturë, e cila duhej të implementohej ashtu siç ekziston edhe në vendet e rajonit. Si shembull ju kujtoj Slloveninë, Kroacinë, Maqedoninë, Britaninë e Madhe dhe vende të tjera të OECD-së, të cilat funksionojnë në dy parametra. Një mënyrë funksionaliteti është: një njësi qendrore, e cila e kryen shërbimin me IAL-të, pra me fakultetet e edukimit, por ka raste në bazë të buxheteve dhe të ardhurave që kanë shtete të caktuara, ku gjithë shërbimin e merr njësi, e cila mund të quhet institut apo shkollë drejtorësh, kjo pak rëndësi ka. Pra këto janë dy rrugët.

Kemi pasur një bashkëpunim fillestar me UNICEF-in, ka qenë një projekt pilot për rreth 9 muaj, i implementuar kryesisht me përfaqësues ose specialistët më të mirë që ne kemi në arsim nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit, nga Agjencia Kombëtare e Provimeve, por edhe nga fakultetet e edukimit dhe, pas pilotimit, u jemi drejtuar të gjithë partnerëve të tjerë ndërkombëtarë për ndihmë dhe mbështetje, pasi na sugjerohet se kjo është një eksperiencë pozitive dhe këtu krijohet lidhja me Fondin Amerikan, të cilët mund të flasin vetë për vazhdimësinë dhe mënyrën e subvencionimit. Ne kemi pasur një debat konstruktiv me përfaqësues të Departamentit Psiko-pedagogjisë së Fakultetit të Shkencave Sociale, si në publik, ashtu dhe ballë për ballë me profesor Bardh Musain, me Nikoleta Miton dhe me emra të tjerë që nuk dua t'i përmend, dhe diskutimi ka qenë nëse programi i shkollës së drejtorëve bie ndesh me kurikulat që kanë masterat e menaxhimit dhe drejtimit në arsim. Kur e kemi inicuar këtë debat, kemi diskutuar dhe kemi thënë që një njeri që ka master në administrim drejtimi, nuk ka qenë i detyruar për të marrë pjesë në një shkollë

leadershipi, pra ka qenë i lirë ky diskutim, ndërkohë që me evolimin e idesë dhe me krijimin e këtij institucioni, unë besoj se diskutimet e para janë që ky shërbim të kryhet po me fakultetet e edukimit. Pra, në projektin që ne kemi, nuk ekziston një koncept që kjo shkollë të kryejë e vetme hartimin e kurikulës. Sigurisht hartimi i saj do të ketë partneritet me ekspertët lokalë dhe ndërkombëtarë, por synon fuqizimin e fakulteteve ku krijohen mësues në të gjitha rajonet, duke filluar nga Korça Elbasani, Durrësi, Shkodra dhe Vlora, duke bërë edhe një shpërndarje të burimeve njerëzore dhe mënyrën se si delegohet shërbimi. Ky ka qenë, pak a shumë, diskutimi dhe debati që kemi pasur.

Ashtu siç kemi bërë me fuqizimin e fakulteteve të shkencave sociale, kemi akredituar qendrat e trajnimit të mësuesve në fakultetet e shkencave të edukimit, pra atje ku formohen mësues, po përpiqemi të stimulojmë maksimalisht që mësuesit në rajonet e tyre t'u drejtohen më shumë fakulteteve ku formohen kurikulat e tyre dhe ku ata diplomohen, edhe për trajnimin në vazhdim sesa agjencive që mund të kenë dilema dhe skepticizëm, por në qasjen tonë janë partnerë seriozë, sepse janë përfaqësues të trupave diplomatike.

Valentina Duka – Edhe një pyetje, ku do të afilohet shkolla, do të jetë e pavarur, do të varet nga Ministria e Arsimit apo do të afilohet pranë ndonjë institucioni akademik?

Gentian Sejrani – Shkolla do të afilohet, do të jetë në një ambient...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Është subjekt juridik privat. Në filozofinë e Fondit Amerikan buxheti i alokuar menaxhohet nga fondi, pra nuk merret asnjë lek nga buxheti i shtetit. Krijohet institucioni me përfaqësues të ekspertizës ndërkombëtare dhe lokale, mund të jenë pedagogë të fakulteteve, të cilët ndërtojnë kurrikulat; është një institucion, i cili ndërvepron me Qendrën e Shërbimit Arsimor për të marrë të dhënat nga licencat, provimet e shtetit e të tjera; sigurisht në partneritet me fakultetet, do të ofrojë të gjithë shërbimin.

(Diskutime pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Ju lutem, a mund të vendosim një rregull për të operuar? Do t'ju lutesha shumë, sepse kemi jashtë rektorët duke na pritur, pasi ata kanë punët e tyre dhe nuk mund të rrinë për shumë kohë, prandaj do t'ia jepja fjalën Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim. Keni 2 minuta kohë për t'u përgjigjur.

Ju, zotëri, kishit nevojë për ndërhyrje?

Çështjen që kemi ta mbyllim këtu dhe të thërrasim rektorët, sepse kanë 35 minuta që presin.

Jeni dakord?

Faleminderit!

Jonida Lamaj – Për pyetjen tuaj të parë, që i përket veprimtarisë së fushës dhe ekspertizës, sektori për arsimin dhe edukimin është një nga katër shtyllat kryesore të veprimtarisë së fondacionit dhe një pjesë e konsiderueshme e projekteve dhe e programeve që operon fondacioni janë në fushën e arsimit, jo vetëm në fushën e arsimit parauniversitar, por edhe në fushën e arsimit të lartë. Bashkëpunimi i fondacionit me Ministrinë e Arsimit daton që herët, pra që nga viti 2012, ku disa nga programet dhe projektet më të suksesshme që ka pasur deri më sot kanë qenë programi “Junior Achievement” dhe “Clean Scoor”, dixhitalizimi i vlerësimit të testimeve, ndërkohë që vijon me idenë e krijimit të Shkollës së Drejtorëve, një program, të cilin e ka vlerësuar edhe bordi më së miri për një domosdoshmëri që i nevojitet arsimit parauniversitar në Shqipëri.

Për sa i takon pyetjes suaj të dytë, bashkëpunimi me institucionet e arsimit të lartë është menduar që në fazën e konceptimit. Edhe më parë në tryezat e diskutimit që janë zhvilluar, është biseduar me përfaqësues të Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale, të cilët kanë programe masteri me drejtim arsimin për mënyrat e bashkëpunimit. Kuptohet, ndërtimi i kurrikulave, ekspertët që do të jenë lektorë pa dyshim do të jenë pjesë e stafëve apo ekspertë aktualë dhe kjo është bërë në bashkëpunim me profesorë lokalë.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Zotëri, dëshironi të thoni ndonjë gjë?

Klaudio Pulaha – Përshëndetje të gjithëve!

Unë quhem Klaudio Pulaha, përfaqësues i Koalicionit për Arsimin në Shqipëri. Nuk do të doja t’ju bezdisja me diskutimin tim meqë jam folësi i fundit, por dëgjova këtu që u diskutua për sa i takon anës procedurale, mënyrës se si zgjidhen drejtorët e të tjera. Për mendimin tim është diçka shumë e mirë që këto gjëra të diskutohen, por çështja është se bëhen ligje. Por ne nuk i kuptojmë ose më saktë e anashkalojmë faktin që këto ligje ose përgjegjshmëria apo përgjegjshmëria e të rriturve bie direkt tek fëmijët.

Dëgjova të flitej pak për fëmijët dhe se sa preken ata nga ky ligj, prandaj do të doja pa humbur kohë t’ju sillja në vëmendje disa statistika që vërtetë janë shumë të rëndësishme dhe të merren parasysh kur diskutohen këto ligje. Nuk e di se sa prej jush janë në dijeni të një programi që është zbatuar vite më parë “A Kombi”, por në qoftë se u referohemi statistikave të këtij

programi 41% e fëmijëve në sistemin parauniversitar raportojnë se kanë të bërtitura sistematike nga mësuesit dhe të rriturit...

Milva Ekonomi – Ju ftoj, t’i mbështesni rekomandimet tuaja, pasi na kanë ardhur në komision dhe të gjithë deputetët i kanë përpara dhe do t’i shqyrtojmë kur të kalojmë në diskutimin nen për nen.

Klaudio Pulaha – Kjo është mëse e drejtë. Jam i bindur që kolegja ime Albana i ka parashtruar, por përsëri nuk shoh vëmendje për sa i takon çështjes së fëmijëve. Është shumë e rëndësishme dhe nuk e di...

(Diskutime pa mikrofon.)

A mund të vazhdoj? E quani të rëndësishme atë që jam duke folur, apo...

Milva Ekonomi – Ju lutem, ta dëgjojmë përfaqësuesin e Koalicionit për Arsimin Cilësor në Shqipëri! A mund të flasë zotëria, sepse e kemi thirrur në dëgjuesë?

Klaudio Pulaho – Ju lutem, dëgjoni pak atë që kam për t’ju thënë për fëmijët!

Do të doja ta përforcoja edhe një herë faktin e një neni shumë të rëndësishëm në ligjin që ju po diskutoni, neni 32. Ne e kuptojmë dhe e dimë shumë mirë realitetin e institucioneve arsimore në Shqipëri, prandaj jo më kot më parë doja ta nisja me disa statistika, por ndoshta nuk janë shumë të rëndësishme për ju, por do të doja t’ju sugjeroja edhe një herë dhe të mbahej shënim që institucioni arsimor ka për detyrë krijimin e mjedisit miqësor për nxënësit, të respektojë të drejtat e fëmijëve dhe të njeriut, të mbrojnë fëmijët nga dhuna dhe të krijojnë mundësinë që secili nxënës të shfaqë, të zhvillojë dhe të realizojë potencialin e tij human.

Ju lutem, janë shumë të rëndësishme diskutimet që sapo bëtë, por, ju lutem, nëpërmjet këtij ligji drejtojeni vëmendjen nga fëmijët. Jam shumë dakord me ju kur folët për pjesën se si emërohen drejtorët dhe ne si Koalicion për Arsimin në Shqipëri e ngremë si shqetësim faktin që drejtorët e parashkollorëve emërohen nga Bashkia, por kjo do të thotë se frika jonë si Koalicion për Arsimin në Shqipëri është se si mund të mendohet të emërohet nga një institucion përkatës drejtori i X institucioni dhe sa të mbrojtur do të jenë mësuesit e këtyre institucioneve arsimore që të mos përdoren politikisht dhe të mos kenë presion në zgjedhjet lokale dhe kombëtare.

Faleminderit shumë!

Të gjitha sugjerimet që ne si Koalicion i Arsimit në Shqipëri ju kemi sjellë sot, i keni edhe nëpërmjet *e-mail*-it dhe të printuara, prandaj do t’ju luteshim për më shumë vëmendje, se jo më

kot jemi në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik. Kthejeni vëmendjen nga fëmijët, sepse çështjet procedurale mund të jenë për një moment të dytë!

Milva Ekonomi – Faleminderit!

Dua t’ju falënderoj të gjithëve jo vetëm për kohën tuaj, duke qenë të pranishëm sot në komision, por edhe për depozitimin me shkrim që u keni bërë të gjitha komentete tuaja. Pa dyshim komentet tuaja do të trajtohen në diskutimin nën për nën të projektligjit.

Faleminderit!

Të gjithë kolegëve të komisionit, tani do të presim rektorët dhe dekanët e universiteteve të mësuesisë, të cilët do të jenë të pranishëm në dëgjësë.

II - Milva Ekonomi - Mirëdita!

Faleminderit që jeni të pranishëm!

Ju kërkoj ndjesë për vonesën, si dhe ju falënderoj për durimin, pasi ne e kemi të nevojshme të dëgjojmë mendimin tuaj për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”,

Të nderuar kolegë, Për sa i takon dëgjësës së dytë të projektligjit, të pranishëm në komisionin tonë janë: Prof., Dr. Roland Zizi, rektor i Universitetit “Ismail Qemali” në Vlorë; Prof. e Asos., Dr.Valbona Duri, zëvendësrektore e Universitetit “Eqerem Çabej” në Gjirokastrë; Dr. Erana Bilali, përgjegjëse e Departamentit të Mësuesisë në Fakultetin e Shkencave të Edukimit në Universitetin “Luigj Gurakuqi” në Shkodër.

Faleminderit që jeni të pranishëm!

Do të doja opinionin tuaj për sa i takon projektligjit dhe nëse e shihni të nevojshme, t’i ndani opinionet tuaja me anëtarët e komisionit tonë.

Roland Zizi – Faleminderit, zonja drejtuese e komisionit!

Të nderuar deputetë,

Unë quhem Roland Zizi, rektor i Universitetit “Ismail Qemali” në Vlorë. Ju falënderoj për ftesën që më keni bërë, e cila është në vijim të konsultimeve paraprake që Ministria e Arsimit ka realizuar me Universitetin “Ismail Qemali”, por edhe me universitetet e tjera për projektligjin për disa shtesa në ligjin “Për arsimin parauniversitar”.

Në një vlerësim të përgjithshëm nga ana ime, duke shprehur këtu edhe mendimin dhe opinionin e Fakultetit të Mësuesisë, të departamenteve dhe përgjegjësve të departamenteve të

Universitetit “Ismail Qemali” të Vlorës, i gjej me vend shtesat që janë paraqitur në këtë projektligj për të plotësuar ligjin e arsimit parauniversitar.

Sipas mendimit tim nenet e shtuara në këtë ligj plotësojnë disa boshllëqe të cilat, herë pas here në jetën e arsimit parauniversitar dhe të institucioneve, por edhe të prindërve dhe të komunitetit, kanë pasur disa problematika, prandaj mendoj se disa shtesa i plotësojnë këto boshllëqe dhe janë në koherencë me zhvillimet parauniversitare, shoqërore dhe kulturore në vendin tonë. Sigurisht e gjej me vend ngritjen e asaj strukture që quhet Këshilli Kombëtar i Arsimit Parauniversitar, por kam një propozim lidhur me atë që do të ishte ndoshta efikase dhe më racionale që edhe universitetet shqiptare të kishin një përfaqësues në Këshillin Kombëtar të Arsimit Parauniversitar.

Universiteti është institucioni, i cili jo vetëm zhvillon programe studimi në fushën e mësuesisë, por nisur nga eksperiencia, ky institucion ka dijeni dhe njohje të plotë për zhvillimet parauniversitare në Shqipëri. Pra, sipas mendimit tim një përfaqësues nga universiteti në Këshillin Kombëtar do të ishte efikas dhe i drejtë.

E gjej me vend edhe ngritjen e Këshillit Kombëtar të Prindërve, edhe kjo është një risi që e plotëson pak a shumë kuadrin tërësor ligjor të arsimit parauniversitar apo edhe anekset e përcaktuara edhe për Këshillin Kombëtar Parauniversitar, por edhe për Këshillin Kombëtar të Prindërve. Sigurisht, kur vjen puna te drejtorët e shkollave, edhe ky është një element tjetër i rëndësishëm i ligjit, por ne si universitet deri tani nuk kemi një program studimi për drejtor shkolle, por në të ardhmen do të aplikojmë në Agjencinë e Akreditimit. Nisur nga kjo, doja t’ju bëja një pyetje. A do të lejohen universitetet, përveç ministrisë, të kenë programe studimi për drejtues shkolle?

(Diskutime pa mikrofon.)

Ky është vlerësimi im.

Milva Ekonomi – Përfaqësuesit e ministrisë, a i morët shënim disa nga këto pyetje?

Kush nga zonjat e do fjalën?

Fjalën e ka Valbona.

Valbona Duri – Përshëndetje të gjithëve!

Ju falënderojmë për ftesën që edhe universitetet të jenë pjesë e diskutimit dhe e dhënies së mendimit të tyre për këtë projektligj plotësues për arsimin parauniversitar. Realisht ky projektligj sjell risi për arsimin parauniversitar.

Shkurtimisht, në vija të përgjithshme, i mbështes mendimet dhe sugjerimet e dhëna nga zoti rektor, si dhe mund t'ju them se Këshilli Kombëtar i Prindërve është një mekanizëm, i cili do të luajë një rol të rëndësishëm në plotësimin ose në realizimin e komunikimeve plotësuese me ministrinë.

Ne jemi pro mendimit dhe idesë të funksionimit të Shkollës së Drejtorëve, duke mbështetur plotësisht mendimin që edhe universitetet të jenë pjesë në këtë këshill kombëtar, si dhe vlerësojmë rolin e përgatitjes së drejtuesve të institucioneve të arsimit parauniversitar në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.

Ajo që do të doja të theksoja më shumë ka të bëjë me plotësimin e nenit për sigurimin e shkollave, sepse nevojitet që ky sistem të përforcohet, pasi ka të bëjë me sigurimin e këtyre ambienteve. Për sa i takon administrimit dhe menaxhimit të të ardhurave të universiteteve, që i përket nenit 9, i cili është një plotësim i ndryshimeve të nenit 38 të ligjit aktual, ai u jep mundësi institucioneve arsimore të administrojnë buxhetet financiare dhe të kenë mundësi për të menaxhuar të drejtat e tyre për krijimin e të ardhurave të shërbimeve ndaj të tretëve me qëllim që këto fonde të përdoren në dobi të shkollave.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Faleminderit!

Fjalën e ka zonja Erana.

Erana Bilali – Faleminderit!

Unë nuk jam në cilësinë e rektores, por të drejtoreshës së departamentit; ju përgëzoj për ftesën, si dhe konsultimin që po zhvillon, duke përfshirë edhe universitetet!

Bashkohem me mendimet e parafolësve dhe mendoj se ky ligj sjell shumë risi, sidomos për sa i takon përfshirjes së prindërve në jetën e shkollës, aq më tepër në jetën e komunitetit dhe është në vazhden e risive që ka sjellë politika në lidhje me shkollën dhe arsimin në përgjithësi. Personalisht mendoj se në Këshillin Kombëtar të Prindërve duhet të jetë një përfaqësues i universitetit dhe njëkohësisht shkollat për përgatitjen e drejtorëve t'u jepen si ekskluzivitet universiteteve, sepse është mjaft e rëndësishme përfshirja e universiteteve në përgatitjen e drejtorëve të shkollave, pasi i mendoj drejtorët jo më siç ishin deri tani, por edhe si administratorë dhe kjo kërkon edhe një konfigurim të përgatitjes së tyre si specialistë për drejtimin e arsimit.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Nga kjo dëgjese që po zhvillohet, kam përshtypjen se dëgjuam pyetje nga kolegët për ministrinë. A mund t'ua japim fjalën përfaqësuesve të ministrisë për të kthyer një përgjigje për sa i takon pyetjes që u bëri rektori i Universitetit të Vlorës dhe, më pas, pasi ta ezaurojmë përgjigjen, të shohim nëse anëtarët e komisionit kanë pyetje për përfaqësuesit e arsimit?

Genti, do të vazhdoni të përgjigjeni ju, apo ndonjë tjetër?

(Diskutime pa mikrofon.)

Mendoj se duhet t'i pyesim tani përfaqësuesit e arsimit, sepse më vonë do të fillojmë diskutimin nën për nen të projektligjit dhe zotërinjtë që janë të pranishëm do të largohen.

Zoti Rrokaj, a na mbështesni në diskutimin që sapo filluam?

Shezai Rrokaj – Unë mendoj se një rektor, në rastin konkret rektori i Universitetit të Vlorës, i cili i përket një qarku që përfaqësohet edhe nga disa deputetë të komisionit tonë, shprehu vullnetin për të qenë bashkëpjesëmarrës në këtë shkollë. Pra, me aq sa na u shpjegua nga përfaqësuesit e ministrisë dhe të fondacionit për idenë e krijimit të kësaj shkolle, unë e mbështes propozimin e Landit, të cilin e kemi mik, si dhe të Këshillit Kombëtar, që universitetet të jenë partnere për realizimin e kësaj shkolle dhe kjo të fiksohet me ligj. Në këtë mënyrë universitetet do të përfshiheshin, por do të përfshihen edhe katedra që merren me menaxhimin e arsimit, si projektues të dijes në mësuesi.

Është mjaft e rëndësishme që universitetet e mësuesisë pa bërë dallimin nëse janë publik apo privat, sepse ne nuk jemi këtu për të bërë këto dallime, duhet të jenë partnere të projektit, qoftë edhe në bashkëpunim. Unë mendoj që kjo të mos vihet në relacion, por një fondacion duhet të konkurrojë për këtë gjë, sepse nuk kemi pse ta paracaktojmë. Por në qoftë se ju i qëndroni kësaj ideje, të paktën mos i qëndroni idesë që universitetet të mos jenë pjesëmarrëse në bashkëpunim për hartimin e kurrikulave, menaxhimin dhe realizimin e saj.

Ky është propozimi që unë kam. Në fakt, kam edhe një propozim tjetër, por atë do ta shohim kur ta kalojmë projektligjin nën për nen.

Milva Ekonomi – Fjalën e ka zoti Zizi.

Roland Zizi – Në asnjë moment të fjalës sime nuk kërkova apo nuk bëra propozim që universitetet duhet të jenë partnerë me shkollën e drejtuesve që do të hapë ministria, por kërkova partneritet vetëm për të shtuar një person, përfaqësues të universiteteve në Këshillin Kombëtar të Arsimit Parauniversitar.

Pyetja ime kishte të bënte vetëm me faktin nëse universitetet mund të pengohen...

Shezai Rrokaj – Po ju bëj një pyetje. Zoti rektor, ju si drejtues i një universiteti që përgatisni mësues për sistemin parauniversitar, a mendoni se i keni kapacitetet e duhura për të dhënë kontributin tuaj si universitet në shkollën që mendohet të krijohet për drejtimin e shkollave apo jo?

Roland Zizi – Së pari, përderisa ne si universitet zhvillojmë programe studimi në fushën e mësuesisë, sigurisht që i kemi të gjitha kapacitetet jo vetëm për veten tonë, por edhe për ndonjë institucion apo partneritet tjetër, që ta bëjmë këtë gjë. Në këtë moment unë nuk artikuloja që ne të jemi partnerë në këtë shkollë, sepse ne kemi të drejtën dhe autonominë tonë për të ngritur dhe për të zhvilluar programe studimi. Kapacitetet i kemi, absolutisht.

Milva Ekonomi – Po, zoti Tola.

Erzen Tola – Faleminderit!

Si përfaqësues i ministrisë do të doja t'ju sqaroja ndryshimet lidhur me pikën 4 të nenit 29 të ligjit aktual ose të nenit 6 të projektligjit. Ministria e Arsimit nuk ka bërë asnjë lloj rikompozimi në çastin e propozimit të projektligjit për Këshillin Kombëtar të Arsimit Parauniversitar. Janë bërë vetëm saktësime të institucioneve qendrore të ministrive të linjës, përshtatje të emërtimeve dhe kemi hequr komunat, duke qenë se janë hequr si institucione. Këshilli nuk ka asnjë ndryshim.

Nga të gjitha fazat e konsultimit publik ne nuk kemi marrë asnjë propozim nga institucionet e arsimit të lartë apo nga partnerë të tjerë, që të shtonim anëtarë në këshill. Ky shtim do të kërkonte procedura të mëtejshme, sepse në qoftë se do të përcaktojmë përfaqësues nga institucionet sikurse edhe nga partnerët e tjerë socialë, do të themi edhe se si do të zgjidhet ky përfaqësues, si do të bëhet anëtar, kush do ta propozojë, pasi për përfaqësuesit, personalitete, në këtë këshill, zhvillohet një procedurë konkurrimi e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave. Pra, ne nuk kemi bërë asnjë ndryshim në këtë pikë, por kemi bërë vetëm saktësimin e emërtimeve. Këshilli është ai që ka qenë, pa asnjë ndryshim.

(Diskutim pa mikrofon.)

Gerti Janaqi – Disa nga universitetet dhe fakultetet kanë mastera, tashmë prej disa vitesh. Asnjë nuk i pengon rektorët dhe dekanët, se janë ende autonomë, që të hapin programe dhe t'i akreditojmë.

Shpjegimi që bëra kishte të bënte me një linjë logjike. Kemi rreth 3-4 vjet që po përpiqemi ta përforcojmë bashkëpunimin me një aleat. Ashtu siç...

Valentina Duka - Më fal, në qoftë se ne...

Gerti Janaqi – Po shkojmë në një linjë diskutimi, ta mbarojmë dhe pastaj ...

Valentina Duka - Në qoftë se hapim mastera në menaxhim, ligji juaj nuk i punëson si drejtorë ata që mbarojnë masterin, punësohen si të tillë vetëm ata të shkollës së drejtorëve.

Gerti Janaqi – Unë po shpjegoja një logjikë që ka lidhje edhe me funksionimin. Po me IAL-të, por nuk e prek ky ligj, se është çështje e reformimit të kurrikulave të mësuesisë!

Ne jemi në bashkëpunim progresiv. Kemi ngritur grupe pune me çdo fakultet dhe universitet, që drejtohen nga vetë përfaqësues të IAL-ve dhe sigurisht që koordinohen edhe me kontributet tona. Pra, përderisa ne po ecim me unifikimin e kurrikulave ku formohen mësuesit, ekziston edhe një mundësi e dytë përtej dëshirës nëse duan IAL-të të angazhohen ose jo, që, nëse do të ketë një kurrikul kombëtare të integruar për menaxhimin e drejtimit të shkollës, të ketë një ftesë edhe për përfaqësuesit e universiteteve shqiptare.

Mund të ketë universitete që duan ta pranojnë, po marr rastin e Elbasanit, të Shkodrës, Durrësit apo Korçës. Ashtu siç mund të ketë universitete të tjera që nuk do të donin të bëheshin pjesë e kësaj shkolle. Në logjikën tonë, do të ishte ndihmë e madhe për të shpërndarë burimet njerëzore, marrjen e shërbimit, edhe për hir të afërsisë gjeografike etj., etj., kështu që...

Milva Ekonomi - Besoj se do të ketë nevojë për thellime, edhe kur ta kuptojmë të gjithë logjikën e projektligjit që kemi në dorë. Ju bëni këto pyetje, se vini nga dija dhe falë eksperiencës që keni...

(Diskutim pa mikrofon.)

Do ta shikojmë në nen, që ta rregullojmë këtë gjë.

(Diskutim pa mikrofon.)

Për ne është e rëndësishme që e morëm këtë lloj shqetësimi nga dëgjesa.

(Diskutim pa mikrofon.)

Do t'ju lutesha shumë, kolegë!

Këtë shqetësim e morëm nga dëgjesa dhe ministria e kuptoi shqetësimin që po ngrihet këtu, kështu që, kur të diskutojmë nen për nen, do të doja t'ju bëja të gjithëve një thirrje, që të ulemi dhe ta mendojmë siç duhet hartimin e këtij neni specifik.

Unë mendoj ta mbyllim me dëgjesat, sepse është më mirë që...

(Diskutim pa mikrofon.)

Kejdi Mehmetaj – Ideja është që, në qoftë se profesorët nuk kanë diçka për të thënë, e vazhdojmë...

(Diskutim pa mikrofon.)

Milva Ekonomi - Dua t'ju falënderoj që ishit prezentë!

Ishit shumë konçizë dhe na dhatë kaq shumë debat!

Së dyti, dua t'ju falënderoj gjithashtu për 30 minutat kohë që ju mbajtëm më tepër! E dimë që jeni të ngarkuar. Faleminderit për durimin!

Roland Zisi - Ju faleminderit!

Ne e duam shkollën e drejtorëve!

Milva Ekonomi - E kuptuam që doni të jeni pjesë aktive e kësaj shkolle.

Faleminderit! Ditë të mbarë!

(Largohen përfaqësuesit e universiteteve publike.)

Mbyllet pjesa e parë e rendit të ditës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

Tiranë, më 18.07.2018, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Milva Ekonomi – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Diskutimi dhe votimi nën për nën dhe në tërësi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.””(komision përgjegjës).

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Fatmir Velaj, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Adelina Rista, Bujar Çela, Almira Xhembulla, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Romeo Gurakuqi, Valentina Duka, Kejdi Mehmetaj, Shezai Rrokaj dhe Nora Malaj.

Mungojnë:

Albana Vokshi.

Të ftuar:

Besa Shahini – zëvendësministre e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë,
Zamira Gjini - drejtore e Përgjithshme për Politikën dhe Zhvillimin e Arsimit, Sportit dhe Rinisë,
Gerti Janaqi - drejtor i Institutit të Zhvillimit të Arsimit,
Erzen Tola – drejtor në Drejtorinë e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator,
Mariglen Mërtiri – këshilltar për mediat.

Vijon pjesa e dytë e rendit të ditës

Milva Ekonomi - Fillon pjesa e diskutimit nen për nen.

Fjala për zonjën Mehmetaj.

Kejdi Mehmetaj – Kisha dy pyetje para se të kalojmë te diskutimi nen për nen lidhur me shkollën e drejtorëve, sepse tani u bë më konfuze se ç’duhet.

Së pari, kur shpjegoi më parë zotëria, tha se shkolla do të jetë një entitet privat. A mund të na shpjegoni se çfarë kuptoni me fjalët “entitet privat”?

Së dyti, krijimi i shkollës së drejtorëve, krahas masterave që ekzistojnë aktualisht në IAL-të shqiptare, si e përballon konkurrimin në nivel punësimi? Pra, futja në ligj e shkollës së drejtorëve, do të thotë që kur të punësohet një drejtor, duhet që detyrimisht të ketë mbaruar këtë shkollë. Kjo shpjegon në deduksionin logjik se masterat bien poshtë për çështje punësimi.

Besa Shahini – Jeni e sigurt që nuk doni ta bëni pyetjen kur të arrijmë te shkolla e drejtorëve nen për nen?

Milva Ekonomi - Duam ta dëgjojmë tani përgjigjen!

Besa Shahini – Për pjesën e dytë, shkolla e drejtorëve bën certifikim, kështu që është plotësisht e mundur që dikush që merr një master në menaxhim shkolle, të kalojë edhe këtë testin që duhet të bëjë...

(Diskutim pa mikrofon.)

Absolutisht! Kjo është ideja, se ka nevojë të vendoset një lloj filtri, në mënyrë që të përmirësohet...

Kejdi Mehmetaj – Faleminderit, zonja zëvendësministre!

Besa Shahini – Më lejoni ta përfundoj fjalinë!

...Ka nevojë të vendoset një lloj filtri, në mënyrë që të përmirësohet sa më mirë menaxhimi i shkollës së shekullit XXI.

Kejdi Mehmetaj – Pse duhet të vazhdojë një master për mësuesi apo për drejtim – menaxhim të shkollave një individ X, kur duhet të kalojë te shkolla e drejtorëve?

Besa Shahini – Për shkak se nevojitet gjithsesi të ketë një master të kryer të unifikuar për t’u bërë mësues apo drejtor.

Kejdi Mehmetaj – Po bën direkt shkollën tuaj, pra, dhe nuk ka nevojë për të kaluar...

Besa Shahini – Në mënyrë që dikush të bëhet drejtor, mësues apo çfarëdo pozicioni në sistemin arsimor, duhet të ketë një master të kryer, ciklin e dytë.

Kejdi Mehmetaj – Po them master menaxhimi, jo master mësuesie. Ka diferencë kjo!

Besa Shahini –Edhe menaxhimi i ciklit të dytë është një master, i cili kryhet para se të kualifikohet dikush për t’u bërë mësues apo drejtor.

Shezai Rrokaj – A është private kjo shkollë?

Në relacion thuhet që ministria monitoron, që do të thotë, si rregull, ministria do të miratojë kurrikulën, se nuk ka nga shkon dhe i lan duart. Gjithë procesi i menaxhimit është i paqartë, ndërkohë që fondi është jofitimprurës dhe do të japë mbështetjen fillestare për ta krijuar.

Gjithë problemi i menaxhimit është se kush do ta bëjë atë.

Erzen Tola - Lidhur me administrimin e shkollës së drejtorëve, së bashku me Fondin, ministria ka hartuar dhe negociuar të gjithë projektin. Është menduar që shkolla të jetë në cilësinë e personit juridik, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave në formën e organizatës jofitimprurës. Kjo shkollë do të ketë bord drejtues dhe mbikëqyrës, përfaqësues do të jenë anëtarë të fondacionit dhe të ministrisë. Pra, fondi do të ketë bordin që do të mbikëqyrë dhe do të drejtojë të gjithë veprimtarinë. Fondet e dhëna nga fondacioni do të shkojnë në këto borde, që do të shpërndahen dhe do të administrohen gjatë gjithë veprimtarisë së shkollës, veprimtarisë financiare të saj etj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është propozuar në cilësinë e formës së organizatës jofitimprurëse.

Milva Ekonomi - A kemi nevojë të bëjmë ende diskutime për këtë çështje, apo të kalojmë te diskutimet nen për nen?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Para se të kalojmë te diskutimet nen për nen, kemi edhe tri pyetje dhe do e mbyllim me to.

Shezai Rrokaj – A mendoni se te portali “Mësues për Shqipërinë”, pjesa e togfjalëshit “Mësues për Shqipërinë” është një terminologji jo shumë ligjore, por më shumë patetike, propagandistike dhe se një formulim i tillë më ligjor “mësues për sistemin parauniversitar”, që është një term juridik, u qëndron të gjitha kohërave jashtë sensibiliteteve? Në qoftë se do të ishte “Mësues për Shqipërinë”, duhet shtuar edhe një lidhore “që duam” për ta bërë më të plotë. Po jua jap këshillën dhe sugjerimin në mënyrë shumë të pavarur.

Kemi edhe një propozim nga zoti Muhamet, që këto janë ligje, ta ndajmë patetizmin politik propagandistik nga ajo që mbetet në kohë.

Kështu që, pash' Zotin, hiqeni këtë, se nuk shkon! “Mësues në sistemin parauniversitar” ose “për sistemin parauniversitar”, është mjaftueshëm.

Nora Malaj - Mbështetur në propozimet që bëri profesor Shezaiu, edhe unë propozoj që “Mësues për Shqipërinë” ishte terminologji e mirë kur donim të rregullonim sistemin. Të gjithë mësuesit në sistemin arsimor janë mësues për Shqipërinë. Ministria e Arsimit duhet të arrijë në nivelin që t'i bëjë për të gjithë Shqipërinë, por edhe për të gjithë Diasporën e më tej, duke pasur parasysh që diplomat tona janë të integruara dhe të njohura edhe në zonën europiane, pasi vetë procesi i Bolonjës, është proces europian.

Ndaj, do të doja të propozoja të hiqet togfjalëshi “Mësues për Shqipërinë” dhe të lihet portal që lejon futjen e mësuesve në ciklin 1,2,3 dhe 4.

Së dyti, në nenet ku flitet për nivelin e sistemit parauniversitar dhe parashkollor, do të doja që kategorisë së edukatorëve t'u jepet titulli “Mësues”, duke pasur parasysh edhe cilësinë e sistemit të arsimit parauniversitar. Duke pasur parasysh që ju e hapni si pjesë për të hyrë në këtë sistem, do të ishte shumë mirë të rregullohet cikli dhe emërtesa përfundimisht. Duke rregulluar emërtesën, sepse ata, realisht punojnë në sistemin arsimor, do të krijohej mundësia që ky standard të ishte i unifikuar në qasje.

Shkolla e drejtorëve erdhi si nevojë që ata që bëjnë menaxhimin e shkollës, në bazë të ligjit të arsimit parauniversitar. Ata duhet të jenë edhe menaxherë të mirë, sepse shumë shpejt do të vijë një ditë, maksimalisht pas 5 vjetësh, që titullarët e shkollës do të duhet ta buxhetojnë vetë buxhetin e shkollës për të marrë të ardhura dytësore.

Në kuadër të ligjit për pushtetin lokal dhe në kuadër të decentralizimit, do të doja që në dy nenet ku janë të përcaktuara, të vihet më qartë dhe të vendoset më mirë roli i ministrisë si monitoruese, pasi është shumë e nevojshme që një titullar të përmbushë disa kritere sipas ligjeve 1, 2, 3 dhe 4, por roli monitorues nuk është shumë i qartë. Të jepet më i dedikuar, në mënyrë që nesër të mos kemi problematika, se sot shteti për X arsye nuk ka mundësi dhe të ardhura për t'i realizuar këto.

Në nenin që flitet për mësuesit e Diasporës, ajo që do të doja të identifikojë është që shumë mirë që bëhet regjistri i mësuesve dhe shumë mirë që më në fund do t'u jepen certifikata nxënësve dhe atyre që trajnohen, por çështja është: çfarë dedikimi dhe çfarë detyrimi do të ketë Ministria e

Arsimit dhe ministritë e linjës në këtë kuadër? Kjo duhet të jetë definuese, sepse, duke rregulluar këtë definicion, do të kemi mundësinë që strategjia për integrimin e mësuesve dhe detyrimet që kanë lindur tashmë në këtë kuadër, të bëhen shumë më të plotë.

Këto ishin disa nga sugjerimet që kërkoj të vihen në zbatim, duke parë me vëmendje nënë një për një.

Milva Ekonomi - Ka dikush tjetër nga ju gjëra të përgjithshme për të shtuar, para se të kalojmë te diskutimi nën për ne?

Romeo Gurakuqi – Këtu jemi të gjithë mësues.

Prej dy ditësh kemi tentuar të diskutojmë mbi bazën e të vërtetave, domethënë, kemi bërë propozimet respektive, kemi kërkuar që me përjashtim të ndryshimeve dhe të përputhshmërisë së sistemit të ri të krijuar, të mos bëhen ndryshime. Me ç’kam kuptuar, ju do të vazhdoni në plotësimin e tekave të projekteve të Ministrisë së Arsimit, duke krijuar një sistem shumë të ndërlikuar, i cili do të harxhojë para dhe nuk do t’i dërgojë ato te fëmijët shqiptarë dhe te cilësia e arsimit.

Sjelljen dhe komportimin e kolegëve këtu nuk e quaj si të përshtatshëm për mbarëvajtjen dhe synimin kryesor që kemi të gjithë për rritjen e cilësisë dhe mosharxhimin e parave në vende të panevojshme. Ju po bëheni pjesë e saj aty ku nuk duhet dhe nuk merrni përsipër që këto para të harxhohen për cilësinë, për investimet dhe për rritjen e terreneve sportive.

Faleminderit!

Milva Ekonomi - Faleminderit!

Mendoj se ka ardhur koha për të filluar...

Luçiano Boçi - Kam unë një ndërhyrje.

Duke u nisur nga dëgjuesat që patëm sot me grupet e interesit, pjesa më e madhe e të cilave nuk ishte konsultuar dhe nuk ishte marrë për bazë mendimi i tyre, duke u nisur edhe nga parashtrimet e diskutimeve që bëmë dje në parim, ku argumentuam qartë se ndryshimet ligjore kanë shtrat antiligjor dhe, për më tepër, duke u nisur nga koha e shkurtër që është vënë në dispozicion për të diskutuar këto ndryshime që kanë probleme, kemi kërkuar dhe kërkojmë përsëri shtyrjen e diskutimit të këtyre ndryshimeve.

Partnerët nuk janë thirrur, sindikatat kishin vërejtjet e tyre shumë themelore dhe bazike lidhur me ndryshimet ligjore dhe një pjesë e universiteteve nuk janë konsultuar. Këtë e dëshmon mosardhja e tyre këtu në lidhje me ndryshimet dhe paqartësitë që kanë lidhje me masterin, që funksionon në universitetet e tyre.

Duke ditur që të tilla struktura prekin një strukturë të tërë të organizimit të ministrisë, siç janë Këshilli Kombëtar i Arsimit Parauniversitar, mënyra e funksionimit të Inspektoratit të Institutit të Zhvillimit të Arsimit apo të institucioneve të tjera, në emër të opozitës dhe timin, pretendoj që diskutimi dhe koha e vënë në dispozicion është fare e vogël. E kam bërë të qartë edhe në vërejtjet e mia që ministria përdor gjithmonë të njëjtën kohë, fundin e korrikut, fundin e sesionit parlamentar, kur vëmendja e grupeve të interesit është minimale, kur vëmendja e mësuesve, e institucioneve shkollore dhe institucioneve akademike është fare e vogël, duke ditur që ata janë partnerë shumë të rëndësishëm në dhënien dhe marrjen e opinionëve për ndryshimet ligjore që kanë impakte pozitive apo negative tek ata.

Kjo është arsye e mjaftueshme për të kërkuar edhe një herë shtyrjen e miratimit të këtij projektligji dhe shtyrjen e diskutimit nen për nen të tij, për ta vazhduar në sesionin e ardhshëm.

Dua të shtoj edhe një argument tjetër që u tha dje nga kolegët e mi: këto ndryshime nuk sjellin impakte të menjëhershme në arsimin parauniversitar, kështu që mund të kemi kohën e mjaftueshme në dispozicion për ta diskutuar, shoshitur dhe për të dalë në konkluzione shumë më të pjekura sesa këto konkluzione dhe ndryshime që unë i konsideroj të nxituara, përderisa prekin problemin që është prekur gjatë këtyre viteve, siç është emërimi dhe ç'emërimi i mësuesve, pozicioni i drejtorit, çështja e kontrollit të cilësisë së brendshme dhe të jashtme të arsimit parauniversitar dhe çështje të funksionimit apo jo të Këshillit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar.

Në argumentet që sollëm dje theksuam se ligji bie në kundërshtim me disa prej ligjeve funksionale në Shqipëri, por kundërshtia më e madhe ligjore që doli këtu, por nuk u transmetua, është kundërshtia me ligjin e arsimit të lartë. Duhet ta dini mirë, zotërinj të nderuar, që Ministria e Arsimit nuk mund të zhvillojë programe studimi. E kuptoni ku jeni, apo jo? A e kuptoni, më falni për fjalën, injorancën ligjore që po transmetoni? Si mundet që një institucion si Ministria e Arsimit të zhvillojë programe studimi? Bini në kundërshtim me nenin 1 të ligjit të arsimit të lartë dhe me nenin 25 “E drejta për të zhvilluar programe studimi”. Këtë të drejtë e kanë vetëm departamentet dhe fakultetet, nuk e ka as Ministria e Arsimit dhe as Fondi Shqiptaro-Amerikan i Zhvillimit, siç thatë ju. Profesori ndaj i kishte dilemat, sepse nuk mund ta ketë, pasi enti duhet të jetë i licencuar për programe studimi. Zëvendësministria tha se është master i nivelit të dytë, është e vërtetë, sepse është me kredite në universitet dhe është e drejta vetëm e departamenteve dhe fakulteteve. Ministria orienton, nuk zhvillon programe studimi. Jeni krejtësisht në shtrat antiligjor. Ligji i arsimit parauniversitar nuk mund të bjerë në kundërshtim me ligjin e arsimit të lartë, është

absurditet. Ju mund të orientoni kualifikime, madje edhe ju vetë nuk i bëni ato, por i bëjnë partnerët, fakultetet dhe kualifikimet për mësuesit, ose i bëjnë partnerët privatë të licencuar nga ju. Kjo është e drejta juaj, të orientoni dhe të licenconi, por jo të merrni përsipër dhe të zhvilloni një shkollë drejtorësh. Kjo është absurde! Nuk ka vend ku të rrijë! Ndaj kundërshtia jonë ligjore është absolute dhe ju lutem shumë, merreni në konsideratë, sepse në qoftë se do të kishte Gjykatë Kushtetuese, do ta rrëzonte menjëherë këtë gjë, por fatkeqësisht, në Shqipëri nuk ka Gjykatë Kushtetuese. Nuk është e mundur që një ndryshim ligjor në ligjin për arsimin parauniversitar të bjerë në kundërshtim me ligjin e arsimit të lartë. A e keni lexuar nenin 1 të ligjit për arsimin e lartë që flet për misionin e arsimit të lartë? Ministria është orientuese, nuk zhvillon programe studimi. Pra, uluni me këmbë në tokë, se kundërshtitë ligjore janë shumë të forta brenda këtyre ndryshimeve. Ka modalitete për të gjetur zgjidhje, gjejini, por në bashkëpunim me fakultetet dhe jo ta marrë përsipër vetë ministria.

Në qoftë se Fondi ka dëshirë të financojë, partneri kryesor është departamenti, s'ka rëndësi çfarë universiteti. Atje bëhet financimi i trupës akademike, nuk bëhet në këtë mënyrë që e bëni ju “do ta bëjmë në bashkëpunim me pedagogët” dhe me këtë po u hidhni hi syve universiteteve. Jo, kjo nuk bëhet, në mënyrë absolute! Ju nuk mund t'ia hiqni të drejtën departamentit, misionit të arsimit të lartë dhe ekskluzivitetin që ka arsimi i lartë për të zhvilluar programe studimi të caktuara, të cilat janë të licencuara nga Agjencia e Akreditimit.

Ndaj dje patëm përplasje, unë thashë se Instituti i Liderit ka qenë antiligjor, sepse binte në kundërshtim me ligjin për arsimin e lartë dhe ju nuk e pranuat. Sot pranuat çuditërisht që kjo shkollë është vazhdim i atij instituti antiligjor, megjithëse u krijua, u drejtua nga ish-këshilltari i ministres, që është tjetër absurditet, ku ministria posedon anën politike më pas të emërimit të drejtorëve, të cilët kanë qenë të komanduar dhe u licencuan nga ana juaj me një institut antiligjor. Kjo është situata në Shqipëri. Ndërkohë, ju kërkon ta shpëtoni varkën e mbytur, duke i dhënë statusin e shkollës së drejtorëve.

Përpos kësaj, ndryshimet e tjera që i kemi atakuar në lidhje me inspektoratin, ai nuk mund të bashkohet në një institucion të përbashkët me një institucion tjetër që bën politika për arsimin, ndërkohë që ai vetë është një institucion kontrollues dhe garantues i cilësisë së jashtme dhe të brendshme. Inspektorati duhet të ketë autonomi. Në qoftë se ne më parë e iniciuam këtë lloj autonomie, ju e zhdukët duke zhdukur kryeinspektorin dhe tani po zhdukni edhe inspektoratin, ndonëse do të thoni se që funksionet do t'i kalojnë një organizmi të ri brenda strukturës së

ministrisë, por inspektorati është inspektorat dhe ka një rol dhe një organizim specifik. Pjesa tjetër, pra e mënyrës si ka funksionuar Këshilli Kombëtar i Arsimit Parauniversitar, është për të ardhur keq. Nuk e rrit autoritetin e Këshillit vetëm ndryshimi ligjor, është marrja në konsideratë, duke e konsideruar partner atë në ndryshimet ligjore. Unë kam një pyetje të thjeshtë retorike, që këtu nuk është bërë: ndryshimet ligjore miratohen dhe konsultohen edhe me këtë këshill, që duhet të miratojë ndryshimet edhe për veten e vet? Ju nuk e relatuat që e keni bërë një gjë të tillë, aq më tepër që ne kemi evidentuar që, në raste specifike të mënyrës së menaxhimit të procesit mësimor, siç ishte rasti i ndryshimit të orarit, mendimi i Këshillit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar nuk ishte marrë fare në konsideratë.

Të dashur kolegë, jemi në shtrat antiligjor dhe po biem tërësisht në kundërshtim me ligjin dhe me veten tonë. Jemi në një situatë ku ndryshimet strukturore, që ju propozoni kanë karakter tërësisht formal dhe nuk sjellin benefite as për statusin e mësuesit, as për cilësinë e procesit të mësimdhënies dhe as për ato synime që ka arsimi parauniversitar në Shqipëri.

Sigurisht, ndryshimet ligjore janë pjesë e ndryshimeve që kërkon koha, por këto ndryshime kanë kuptim kur shoqërohen me investime. Në arsim nuk mund të bësh reforma pa e çuar atë buxhetin e famshëm në 5 %, se e kemi diskutuar 100 herë, duke i lënë mësuesit me paga mjerane, duke i lënë shkollat të pandërtuara dhe duke i lënë pa mjete mësimore e pa laborator. Këto duhet të bëjë Ministria e Arsimit. Unë e di shumë mire që në mungesë të mjeteve financiare, pavarësisht se i keni premtuar, ju do të vini këtu të bëni *show* kot me ndryshime ligjore, duke thënë “hiqe nga neni 5 e çoje të neni 6, hiq togfjalëshin x dhe shto paragrafin y” dhe, në fund fare, do të dilni me konkluzionin se keni bërë reformë dhe përfitohet nga një element shumë i rëndësishëm. Çdo ndërhyrje në arsim si negativ, ashtu dhe pozitive, i ka impaktet me vonesë në kohë, sepse është në arsim. Këto impakte negative, që ne parashikojmë, duket sikur nuk dalin në 6 muaj apo në një vit, por impakti i tyre negativ do të jetë shumë i madh në atë kohë që pritet të japë impaktin.

Prandaj, të dashur kolegë, të dashur përfaqësues të ministrisë, kërkoj tërheqjen e këtij projektligji, konsultimin e gjerë të tij me grupet e interesit, me përfaqësues dhe me faktorë nga opozita. Ne jemi shumë të gatshëm të japim kontributin dhe mendimin tonë, sepse arsimi është i të gjithë fëmijëve tanë, se janë ndryshime në arsimin parauniversitar dhe nuk mund të jenë kaq politike, edhe pse, në fakt, shumë prej tyre janë. Vend për përmirësime dhe për ndërhyrje ligjore ka, por jo këto ndërhyrje që sillni ju sot dhe që kërkojnë të kapin politikisht në themel sistemin arsimor shqiptar për t’i vënë vulën politike dhe për ta çimentuar politikisht. Nuk duhet të jetë ky

misioni i Ministrisë së Arsimit, prandaj kërkoj tërheqjen e këtij projektligji. Sigurisht, ne nuk do të marrim pjesë te votimi dhe diskutimi nen për nen, pasi jemi kundër kësaj nisme dhe do ta shprehim kundërshtimin tonë, por do të na vinte shumë keq nëse ju do të merrni në qafë politikisht të ardhmen e këtij vendi dhe të fëmijëve tanë me forcën e kartonit.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Fjalën e ka zonja Mehmetaj.

Kejdi Mehmetaj – Faleminderit!

Do të jem shumë koncize. Në emër të grupit të LSI-së ne kemi kërkuar para se të fillonim diskutimin në parim të këtij projektligji, që votimi dhe miratimi i tij në seancën plenare të lihet për sesionin e ardhshëm, në mënyrë që koha në dispozicion për të folur me grupet e interesit, për ta parë ligjin me vëmendje nen për nen, për ta bërë më të plotë dhe konform kërkesave dhe interesave të mësuesve dhe të nxënësve, në radhë të parë, të jetë e mjaftueshme dhe gjërat të bëhen siç duhet.

Për fat të keq, një pjesë e grupeve të interesit nuk kishin mundësi të vinin në komision në afatet që kërkuam, duke qenë se jemi dhe në muajin korrik. Gjatë këtyre dy ditëve që patëm në dispozicion pamë disa probleme thelbësore në ndryshimet që kërkohen të bëhen në ligj.

Problemi i parë ka të bëjë me inspektoratin dhe me ndërhyrjet që bën ligji lidhur me emërimin apo heqjen nga puna të mësuesve, për të vazhduar te legjitimitimi i disa akteve të mëparshme joligjore, që ka ndërmarrë Ministria e Arsimit, siç është portali “Mësues për Shqipërinë”, i cili, siç u tha dhe nga grupet e interesit që patëm pak më parë, është jotransparent dhe nuk ndihmon as në depolitizimin e as në profesionalizimin e mësuesve, të cilët u shërbejnë fëmijëve shqiptarë.

Pa dyshim pika më kritike është shkolla e drejtorëve, që duke u futur më në thelb, për kaq kohë sa kishim, arritëm të kuptonim se ka diçka që fshihet pas atij neni.

Së pari, zbuluam, edhe pse nuk thuhet qartazi, se do të jetë në formë të një enti privat.

Së dyti, do të marrë kompetenca që nuk i takojnë. Kjo nuk mund të vendoset me ligj, sepse bie në kundërshtim me institucionet, tashmë të ngritura, të arsimit të lartë dhe ligjin “Për arsimin e lartë”. Pa dyshim, si portali “Mësues për Shqipërinë”, ashtu edhe shkolla e drejtorëve, do të shërbejnë si një lloj shkolle partie ose ministrie, quajeni si të doni, për të vendosur dhe për të hequr nga puna mësues, të cilët nuk do të vlerësohen më në bazë të aftësive të tyre, por të kontributeve politike, për të mos aluduar pastaj për kontribute korruptive.

Kështu, për të sjellë një produkt, që vërtet do t'u bënte mirë nxënësve shqiptarë, jam e bindur edhe për ju, si deputetë të maxhorancës, mendoj se koha ka qenë e pamjaftueshme për të hartuar ndryshimet apo mendimet në nenet e propozuara. Ne, si grup, kërkojmë mirëkuptimin tuaj dhe mirëkuptimin e qeverisë, por edhe për të bërë një punë serioze, që miratimi i këtij ligji të shtyhet, në mënyrë që në sesionin e ri, në shtator apo në tetor, të kemi kohë që ta rishikojmë me grupet e interesit dhe të bëjmë propozimet përkatëse. Në rast se ju do të vazhdoni me kokëfortësinë tuaj (sepse e kemi thënë tashmë që forca e numrave është e tillë dhe arroganca juaj në drejtimin e këtij parlamenti ka vërtetuar që nuk do të pyesni as për grupet e interesit, as për kolegët e tjerë) për të vazhduar, ne si grup parlamentar nuk do të marrim pjesë as në diskutimet nen për nen dhe as në votimin nen për nen.

Faleminderit!

Milva Ekonomi - Faleminderit, zonja Mehmetaj!

Dua t'ju vë në dijeni se ky ligj është depozituar në Kuvend në datën 18 maj dhe është depozitimi i dytë që i bëhet këtij projektligji, sepse i pari është tërhequr vetë nga ministria për të bërë ndryshimet, sipas kërkesave që kanë ardhur në rritje. Pra, nga data 18 maj deri më sot, që është data 18 korrik, ne kemi pasur mjaftueshëm kohë për të bërë sugjerimet tona. Ju e patë se edhe grupet e interesit ishin këtu dhe nuk është se munguan...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, është në diskutim, ndërkohë që është edhe në kalendar. Ne të gjithë e dimë, sepse jemi të ndërgjegjshëm se si funksionon procedura e Kuvendit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në rregull! Nëse do të ndajmë mënyrën e të punuarit, që dikush punon më ngadalë, dikush tjetër punon më shpejt apo dikush tjetër nuk ka kohë, se ka edhe gjëra të tjera për t'u marrë, unë dua t'ju vë në dijeni se gjërat që po them janë verifikuar nga procedura që ka Kuvendi.

Së dyti, zonja Mehmetaj bëri mirë që e përmendi portalin “Mësues për Shqipërinë”, sepse funksionoi mirë mbi bazën e dy parimeve: të meritës dhe të preferencës. Ky portal na vërtetoi se edhe mësuesit shqiptarë janë të gatshëm të futen në punë sipas kriterëve që kanë edhe kolegët e tyre në vendet e rajonit. Fakti që u mendua se portali “Mësues për Shqipërinë” ishte një portal i paligjshëm dhe mund ishte një paralelizëm me shkollën e drejtorëve, më bën të mendoj se mbase kemi një moment reflektimi, se shkollën e drejtorëve duhet ta shikojmë si diçka pozitive që po vjen në sistem. Shkolla e drejtorëve ka nevojë të konsultohet dhe të diskutohet nen për nen. Falë

diskutimeve që kanë bërë rektorët, falë edhe diskutimeve që kanë bërë sindikatat lidhur me ndryshimet, mund të jenë diçka e mirë për t'i diskutuar nen për nen. Kështu, unë mendoj se mbase është më mirë të qëndrojmë së bashku për ta diskutuar këtë projektligj.

Luçiano Boçi – Atëherë, dua të sqaroj diçka, zonja Ekonomi. Çështja është se një deputeti e studion ligjin në momentin që vjen në *inbox*-in e tij, kur futet në kalendarin e punimeve të seancës dhe jo të punimeve afatgjata 3-mujore apo 6-mujore, aq më tepër që ky projektligj është dorëzuar njëherë dhe është tërhequr për të bërë ndryshime. Ne kemi 3 ditë që i kemi marrë ndryshimet në projektligj dhe koha ka qenë e pamjaftueshme, ndaj i nxorëm këtu problemet, sepse edhe grupet e interesit nuk janë pyetur. Cilat janë grupet e interesit më të rëndësishme? Janë sindikatat, të cilat nuk janë pyetur, sepse e thanë vetë këtu, aq më tepër që ata kanë sjellë vërejtjet e tyre dhe asnjë prej tyre nuk është marrë në konsideratë.

Milva Ekonomi – Ata thanë: “Ishte hera e parë që na pyetën”.

Luçiano Boçi – Jo, sepse ju i thatë që janë në *inbox* dhe mund t'i merrni atje.

Milva Ekonomi – Jo, ata thanë: “Ishte hera e parë që na pyetën”.

Luçiano Boçi – Më falni, unë nuk ju ndërpreva, sepse ishte vetë sqarimi juaj që e dëshmon një gjë të tillë. Për më tepër edhe universiteteve që ju u hyni në kompetencë, nuk ju është marrë mendimi, por edhe fakulteteve të edukimit dhe departamenteve që përgatisin mësues. Kështu që për këto arsye, aq më tepër që ka një bazë antiligjore shumë të fortë, ne nuk mund të marrim pjesë në një maskaradë me ndryshimet ligjore të arsimit parauniversitar, që bien në kundërshtim me ligjin e arsimit të lartë. Kjo është absurde dhe unë nuk e di se si mund të votohet këtu. Unë jua citova edhe nenet dhe kjo është skandaloze. Ne jemi ligjvënës dhe kemi ndërgjegje për atë votë që japim dhe për ndryshimet që paraqesim. Në qoftë se ministria ka bërë gabime të tilla, le të reflektojë dhe t'i sjellë këto gabime, mos kini droje dhe mos hezitoni të merrni mendimet tona; ne jemi të gatshëm në një moment tjetër. Për këto arsye dhe për këto fakte ne nuk mund të diskutojmë një ligj antiligjor.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Ne kemi fatin e madh që i kemi të gjitha materialet me shkrim: edhe të sindikatave, edhe të grupeve të interesit. Kështu që mund t'i marrim në konsideratë në çdo nen, një e nga një.

Kejdi Mehmetaj – Zonja Ekonomi, vetëm për qartësim: në fjalën time fola vetëm për dy veprime, pavarësisht nëse doni t'i dëgjoni apo jo, për përkatësinë partiake dhe për parimin e

korruptivitetit. Unë nuk e di se ku e gjetët pjesën e mirëfunksionimit të kësaj gjëje. Ne do t'u qëndrojmë atyre që thamë, pavarësisht justifikimeve që mund të thoni ju, që brenda një ore të dëgjojmë grupet e interesit dhe të marrim vendime për të bërë ndryshime është e pamjaftueshme. Ne ju ftojme edhe njëherë ta tërhiqni këtë projektligj, ndryshe ne nuk mund bëhemi pjesë e këtij votimi.

Faleminderit!

(Përfaqësuesit e opozitës në komision largohen.)

Milva Ekonomi – Ne e kemi kuorumin për të vazhduar dhe i kemi të gjitha shënimet përkatëse mbi tavolinë. Unë do t'u lutesha të gjithë kolegeve të mi të ulen për qark tavolinës që të jemi afër njëri-tjetrit. Gjithashtu, edhe këshilltari juridik dhe këshilltari teknik i komisionit të qëndrojnë pranë dhe të marrin në konsideratë të gjitha diskutimet dhe komentet që kanë ardhur me shkrim nën për nën, si nga sindikatat, ashtu edhe nga fakulteti.

Para se të fillojmë diskutimin, dua t'i jap fjalën zonjës Adelina Rista, e zgjedhur nga maxhoranca, si relatore e këtij projektligji.

Adelina Rista - Faleminderit, zonja drejtuese e komisionit! Para se të kalojmë te shqyrtimi nën për nën, dua ta përmbledh fjalën time shumë shkurt, duke filluar me falënderimin për ekipin e Ministrisë së Arsimit, që dje në një seancë të zgjatur, përtej etiketimeve të skajshme politike, me qetësi dhe me kompetencë profesionale, paraqitën para nesh të gjitha ndryshimet në projektligj.

Faktikisht ligji ekzistues nr. 69/2012 “Për arsimin parauniversitar” ka 74 nene dhe projektligji që kemi sot ka gjithsej 24 nene. Ndryshimet në projektligj vijnë nëpërmjet 20 neneve, që futen në ligjin ekzistues dhe nenet e tjera janë dispozita kalimtare dhe hyrja në fuqi. Ku konsistojnë dhe cili është qëllimi i këtyre ndryshimeve në projektligj? Qëllimi është pikërisht mbështetja e reformës në sistemin arsimor në tërësi dhe këtu po flasim për sistemin arsimor parauniversitar, mbështetja e kësaj reforme, si dhe bërja sa më efektive dhe e zbatueshme e ligjit. Ky projektligj synon sigurimin e cilësisë së performancës dhe rritjen e eficiencës në sistemin tonë arsimor parauniversitar.

Unë do ta përmbledhja në 4 shtylla kryesore: riorganizimi i gjithë sistemeve të varësisë; përmirësimi i cilësisë në drejtimin dhe administrimin e institucioneve të sistemit parauniversitar; parimi i transparencës; parimi i meritokracisë dhe zhvillimi i burimeve njerëzore potenciale, për të gjithë ata që ushtrojnë profesionin e mësuesit; përfshirja dhe fuqizimi i të gjithë

komunitetit prindëror në hartimin dhe zbatimin e politikave të sistemit tonë arsimor. Ky është fokusi që sjellin ndryshimet e këtij projektligji.

Parë në këtë këndvështrim, unë mendoj se ne duhet të kalojmë në votimin nen për nen. Unë faktikisht i kam të gjitha nenet, që ndryshojnë dhe ku e fokuson ndryshimi i tyre, por kur t'i kalojmë nen për nen, do t'i shikojmë.

Unë ju ftoj që ta kalojmë projektligjin nen për nen.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Faleminderit, zonja Adelina!

Tani do të kalojmë në diskutimin e projektligjit nen për nen.

Në tavolinë keni të fotokopjuara të gjitha kërkesat që kanë bërë grupet e interesit për ndryshime të këtyre neneve që janë depozituar. Ndërkohë, kam bindjen se kolegët e ministrisë kanë marrë shënime nga diskutimet që u bënë këtu në komision ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Patjetër që edhe ne do të bëjmë propozime, se prandaj jemi këtu.

Atëherë, fillojmë me nenin 1, i cili bën ndryshimin e pikës 23, të nenit 2, ku shtohen pikat 24 e 25. A ka komente të depozituara lidhur me këto pika? Nuk ka.

Hedhim në votim nenin 1 me ndryshimet e bëra.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim ? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2, ndryshon nenin 25 të mëparshëm “Funksionet kryesore të ministrisë”. Kush ka komente?

Adelina Rista – Ne i qëndrojmë variantit të qeverisë.

Milva Ekonomi – Atëherë, na ka ardhur një koment me shkrim nga Sindikata e Pavarur e Arsimit të Shqipërisë. Në fazën e dytë të komenteve ka propozuar që në nenin 25 të përcaktohen institucionet e varësisë. A e keni parë komentin?

Erzen Tola – Ne e kemi parë komentin dhe nuk mund ta marrim në konsideratë, sepse tashmë është në fuqi ligji 90/2012 “Për organizmin dhe administrimin e administratës shtetërore”, i cili e përcakton shumë qartë se institucionet e varësisë ngrihen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe nuk mund të jenë më të parashikuara në ligje të posaçme apo në ligje kuadër. Për këtë arsye nuk e kemi marrë në konsideratë për ta shkruar dhe detajuar të gjithë institucionet e varësisë.

Milva Ekonomi – A ka ndonjë mendim tjetër?

Ismet Beqiraj – Unë kam një sugjerim, lidhur me pikën 3, ku thuhet: “Institucionet e varësisë së Ministrisë përgjegjëse për Arsimin, të cilat do të kryejnë funksionet e përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, krijohen me vendim të Këshillit të Ministrave.” Duke parë periudhën e nxjerrjes së VKM-së që është brenda 6 muajve, atëherë për zbatimin e nenit 2, që ka të bëjë me institucionet e të gjitha niveleve, mos ndoshta është vonë 6 muaj dhe duhet ta bëjmë më herët?

Erzen Tola – Lidhur me afatin, ne në ligj kemi parashikuar 6 muaj për të gjitha aktet nënligjore, por disa akte do të dalin shumë më shpejt se 6 muaj. Madje akti për institucionet e varësisë është gati, është vetëm për t’u konsultuar me ministritë e linjës dhe do të kalojë për miratim në Këshillin e Ministrave.

Milva Ekonomi – A ka komente të tjera lidhur me këtë nen? Gjithsej janë depozituar 3 komente. Cili është komenti i tretë?

(Diskutime pa mikrofon.)

Në rekomandimin që ka ardhur nga Qendra për Arsim Cilësor kërkohet që të shtohet një germë “f”.

Besa Shahini - Janë dy arsye pse nuk mund ta marrim parasysh këtë rekomandim.

Së pari, shkak është mënyra se si i adreson kuadri ligjor në Shqipëri fëmijët me nevoja të veçanta, që, në fakt, janë fëmijë me aftësi të kufizuara, kështu që ne nuk mund të fusim një kategori të re.

Së dyti, nuk mund të ndajmë një grupaksion të caktuar të nxënësve, sepse ne thjesht hartojmë dhe zbatojmë politika për të gjithë. Pra, ky propozim nuk qëndron.

Milva Ekonomi – Ai është një propozim i përgjithshëm; mbase ne mund të bëjmë një formulim më të përgjithshëm. Kështu që mund të shtohet një germë “f”, me një propozim më të përgjithshëm, sepse ju në frymën e ligjit e keni këtë propozim. Mbase mund të themi: “Të promovojë një sistem jo diskriminues të arsimit, në të cilin të respektohen të drejtat e secilit person për arsim dhe aftësim, si dhe të ofrohen mundësi të barabarta për arsim cilësor”. Mund të bëhet një definicion më i përgjithshëm.

Zamira Gjini - Ne kemi një nen të veçantë të ligji për arsimin parauniversitar, që është vetëm për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe kemi një dispozitë normative që del pas ligjit, ku edhe aty kemi një kapitull të veçantë që detajojmë çdo gjë për punën dhe integrimin që bëjmë ne për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Milva Ekonomi – Ju nuk mund të diskriminoni, sepse është një gjë e përgjithshme.

Zamira Gjini - Është e përgjithshme, sepse kështu ne mund të themi edhe për fëmijët romë, edhe për fëmijët egjiptianë, pra kemi disa kategori.

Milva Ekonomi – Mosdiskriminimi është karakteristikë e përgjithshme e ministrisë dhe pikërisht kjo gjë, që ju e keni frymë të ligjit, ju mungon në detyrën e ministrisë. Mbase kjo shoqatë ka të drejtë që u jep vëmendje për atë që ajo përfaqëson, por që ta shtoni si frymë të përgjithshme të ligjit, nuk është diçka që nuk i shërben detyrës dhe misionit të ministrisë.

Erzen Tola – Atëherë, në qoftë se mund të shpjegohem edhe nga ana e teknikës legislative, mendoj se një germë e tillë, pikërisht në nenin 25, ku janë funksionet e ministrisë për të gjitha kategoritë e nxënësve, për të gjitha shtresat nuk mund të përfshihet. Ministria ka detyrimin ligjor kushtetues që t'i trajtojë të gjitha shtresat e nxënësve dhe të gjitha kategorive. Për këtë arsye përfshirja e një kategorie të vetme në këtë nen do të konsiderohej mbase edhe diskriminim për kategoritë e tjera.

Zamira Gjini – Ndërkohë, ne kemi edhe nene të tjera, siç është neni i qëllimit të arsimit parauniversitar apo e drejta për arsim, dhe në këto nene në njëfarë mënyre shpërehen të gjitha këto funksione që ka Ministria e Arsimit për të realizuar këtë qëllim. Unë nuk mendoj se duhet të jetë e specifikuar këtu.

Adelina Rista - Nga sindikatat e pavarura tani është një propozim, që të përcaktohen se cilat janë institucionet e varësisë, domethënë të rreshtohen këtu, te ky nen që diskutuam.

Besa Shahini – Ndoshta edhe për informacion, zonja Ekonomi, te neni 63, në fund të relacionit, te parimet e arsimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara, ku janë bërë edhe disa shtesa dhe kjo realisht i mbulon të gjitha propozimet që ka sjellë organizata me emrin Qendra për Arsim Cilësor.

Zamira Gjini – Ndërkohë, te neni 6 “Parimet e përgjithshme të arsimit parauniversitar” është që te institucionet e arsimit parauniversitar zbatohet parimi i gjithëpërfshirjes së nxënësve. Një nga 4 prioritetet e arsimit parauniversitar në strategjinë kombëtare është gjithëpërfshirja.

Milva Ekonomi - A ka komente nga kolegët lidhur me nenin 2, që ndryshon nenin 25? Nuk ka.

Hedhim në votim nenin 2. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.

Kalojmë te neni 3, që shfuqizon nenin 27.

Kemi disa komente nga depozituesit, pasi për këtë nen është bërë një diskutim i fortë, sepse shfuqizohet edhe Inspektorati Arsimor, duke u bashkuar me një emërtim të ri.

Zamira Gjini – Po, ka marrë emërtimin Agjencia Kombëtare e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, e cila është një agjenci që do të rikonstruktohet dhe do të ketë dy drejtime kryesore: hartimin e kurrikulave dhe zhvillimin profesional të mësuesit, si dhe sigurimin e vlerësimit të cilësisë në shkolla. E njëjta strukturë kombëtare, me të njëjtin qëllim dhe funksion, do të zbatohet në çdo bashki.

Në fakt, qëllimi ynë nuk ishte që inspektorati të mos funksionojë më, përkundrazi ne duam që ta çojmë inspektimin në çdo shkollë, në çdo bashki. Kjo strukturë e re arsimore vendore do të krijojë 61 njësi, pra 61 zyra të shërbimit të arsimit parauniversitar, ku një nga strukturat e zyrave do të jetë pikërisht pjesa që do të merret me inspektimin dhe me vlerësimin e cilësisë së institucioneve dhe mësuesve. Pra, do të krijojmë një strukturë të tillë, që do të çojë inspektimin në çdo shkollë dhe te çdo mësues, sipas fushave dhe profileve të tyre.

Milva Ekonomi - Kush është pro nenit 3, që shfuqizon nenin 27? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 4, ku pas nenit 27, shtohet neni 27/1, me këtë përmbajtje: Neni 27/1 “Shkolla e drejtorëve”.

A ka komente nga grupet e interesit?

(Diskutimi pa mikrofon.)

Nga ministria kemi dy komente lidhur me këtë nen, sepse, përveçse ka pasur refuzime, ka pasur edhe konflikte ndërmjet arsimit të lartë dhe arsimit parauniversitar.

Besa Shahini – Kam një koment, sepse kam përshtypjen se zoti Boçi më keqkuptoi më herët.

Shkolla e drejtorëve nuk krijon programe të arsimit të lartë “master”, por do të jetë një institucion më vete. Të gjitha çfarë thamë kanë të bëjnë me kërkesat që bëhen nga institucionet e arsimit të lartë. Pra, programi “master për menaxhim” nuk bie në kundërshtim ...

Milva Ekonomi – Më falni, zonja Besa, që po ju ndërpres!

Unë kam përshtypjen se në këtë moment është e nevojshme të tregohet, si një fabul, se si do të funksionojë shkolla e drejtorëve, sepse është ajo që bëri kakofoni brenda grupit, që nuk u kuptua se si një person, i cili merr një diplomë “master” të nivelit të dytë në mësuesi, ka nevojë që

të bëhet drejtor. Si aplikon ky person për procesin e drejtimit të një shkolle? Mbase kjo është më e rëndësishme të shpjegohet, në mënyrë që ta kemi të shënuar në procesverbalin e kësaj mbledhjeje.

Zamira Gjini - Shkolla e drejtorëve ka ardhur si nevojë e arsimit parauniversitar, sikurse u pilotua dhe u bë një model i 200 drejtorëve të parë, ku u certifikuan nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit. Kjo nevojë ka qenë e Ministrisë së Arsimit, që duke kontaktuar me Fondin Amerikan për Zhvillim, të cilët edhe ata kishin në prioritet e tyre investimin në arsim, u koordinuan së bashku për ndërtimin e një institucioni të tillë. Pra, shkolla e drejtorëve është një institucion juridik që bën dy gjëra: trajnimin e çdo personi kandidat për t'u bërë drejtor ose trajtimin e një personi që është drejtor në një shkollë.

Shkolla e drejtorëve nuk ka lidhje fare me emërimin e drejtorëve. Ajo, nga njëra anë, bën trajnimin dhe, nga ana tjetër, bën licencimin, certifikimin për të qenë drejtor. Për të marrë certifikimin për t'u bërë drejtor duhet të futesh në një test, sikurse është certifikimi i mësuesve, licencimi i mësuesve. Ne sot na duhet që të kemi një listë të të gjithë atyre që janë të certifikuar për të menaxhuar dhe administruar shkollën. Vërtet ne kemi drejtorë shkollash shumë të mirë, sikurse kemi edhe probleme në pjesën e drejtimit të shkollave dhe kjo na ka bërë që ne të rrisim cilësinë e tyre. Për të trajnuar këta drejtorë ne duhet të kemi këtë renditje të tyre, pra duhet të kemi një listë me drejtorët, të cilët janë të certifikuar nga ky institucion. Ky institucion nuk është i pavarur nga ministria, sepse ai do të funksionojë me një bord drejtues, anëtar i të cilit do të jetë edhe Ministria e Arsimit. Në nenin që ne kemi propozuar mund të themi se funksionimi i këtij institucioni do të bëhet nga Ministria përgjegjëse e Arsimit. Sigurisht, ne tani jemi në diskutime se si do të funksionojë. Në fakt, kemi një model të gatshëm, i cili është realizuar dhe është shumë i ngjashëm me kushtet e arsimit në Shqipëri, qoftë nga numri i mësuesve apo numri i drejtorëve, qoftë edhe nga specifika të veçanta, të cilat mund t'i realizojmë bashkë me Fondin Amerikan për Zhvillim.

Kjo shkollë nuk ka programe formimi, siç e tha edhe zoti deputet, pasi edhe në këtë nen nuk janë përmendur fare programet “master”. Pra, kjo shkollë nuk ka lidhje me programet “master për drejtim” dhe “master për menaxhim”. Për hapjen e programeve “master” është e drejta e universiteteve, të cilat janë autonome dhe ndjekin të gjitha procedurat për hapjen e një programi, duke ardhur deri te Ministria e Arsimit dhe akreditimi i tyre. Nëse një person ka mbaruar një program “master” dhe kërkon të bëhet drejtor në një shkollë, ai duhet të jetë i certifikuar, ndoshta

edhe pa e ndjekur trajnimin, por këtë gjë do ta shikojmë më vonë. Pra, ne në shkollën e drejtorëve do të trajnojmë, do të përgatisim dhe do të certifikojmë drejtorët e rinj, sepse një njeri mund ta ketë bërë programin “master”, por nuk mund të bëhet drejtor, sepse i duhet patjetër të certifikohet në këtë qendër, duhet patjetër që të jetë në listën e drejtorëve të certifikuar, që të emërohet drejtor i një shkolle. Ne kemi parë edhe modele. Për shembull, Franca ka shumë modele të mira, ka listën e drejtorëve të certifikuar dhe nëse i duhet një drejtor, merr listën dhe ai drejtor mund të emërohet jo vetëm pranë vendbanimit të tij, nëse ai dëshiron, mund të shkojë edhe në një zonë tjetër, mjafton që ai të ketë plotësuar kushtet e licencimit. Ndërkohë, ne kemi në procedurë prokurimi për drejtorët, që është një akt nënligjor, i cili përcakton se si zgjidhen drejtorët e shkollave. Pra, shkolla e drejtorëve nuk ka lidhje me emërimin e mësuesve, shkolla e drejtorëve do të bëjë këtë gjë: nëse ti do të emërosh një drejtor, i cili nuk e meriton që të jetë drejtor, por kërkon ta bësh për arsye të tjera, ti nuk mund ta bësh nëse ai nuk e ka certifikatën dhe nuk është i licencuar si drejtor. Kështu që kur ne të bëjmë përsëri udhëzimin, pasi të dalë ky ligj, ndoshta do të shtohet një kriter te konkurrimi për t’u bërë drejtor, i cili do të lidhet me licencimin e drejtorëve.

Bujar Çela – Unë kam një pyetje shumë të thjeshtë, por kam edhe një për procedurë. Kush do të shkojë te kjo shkollë dhe cilat janë kriteret?

Respekt për drejtuesen e seancës, por ajo qenka një karrige shumë e poshtër.

Milva Ekonomi – Këtë të dytën nuk e kuptova aq mirë, por nuk ka gjë.

Besa Shahini – Te kjo shkollë do të shkojë çdo arsimtar që aspiron për t’u bërë drejtor. Në ligj ne nuk mund të fusim procedurat e aplikimit dhe kriteret, këto gjëra do të dalin me akte nënligjore, por patjetër që do të ketë edhe një udhëzim ku procesi i përzgjedhjes do të jetë me konkurrim, pra nuk mund të bëhet kushdo drejtor, sepse duhet patjetër të jetë i licencuar për drejtor.

Milva Ekonomi – Më falni që po ju ndërpres, por ka një pyetje Almira dhe Vilma, pastaj mund ta marrësh fjalën.

Almira Xhembulla – Faleminderit, drejtuese e komisionit!

Në fakt, zonja e sqaroi pak a shumë pyetjen që kisha unë, por t’i rikthehem edhe një herë për ta bërë më të qartë, certifikata që do të lëshojë shkolla e drejtorëve do të jetë parakusht për çdo arsimtar që aspiron për t’u bërë drejtor shkolle? Pra, nuk është një kriter plus, por është një kriter i domosdoshëm? Në momentin që ndryshimet e ligjit hyjnë në fuqi, çdo arsimtar që aspiron për t’u bërë drejtor, duhet të kalojë përmes shkollës së drejtuesve.

Besa Shahini – Askush nuk mund të bëhet drejtor, nëse nuk ka marrë këtë certifikatë.

Vilma Bello– Faleminderit, drejtuese e komisionit!

Unë kam një pyetje në vazhdim të asaj që bëri edhe Almira: kur do të fillojë zbatimi i shkollës së drejtorëve dhe a është menduar që do të ketë një vakum mes atyre që aplikojnë dhe mes atyre që do të fillojnë dhe si do të zgjidhet ky vakum, pra ky ngërç?

E dyta, si do të vazhdojë nëse një mësues licencohet për drejtues në një shkollë të caktuar, çfarë kohëzgjatje do të ketë drejtuesi në këtë shkollë? Si është menduar nëse ai do të largohet, ose nëse ai do të qëndrojë gjatë në atë post, pra sa kohë do të qëndrojnë si drejtues në një shkollë?

Besa Shahini – Ka një nen në ligj ku thuhet se kur shkarkohet drejtori i një shkolle. Nëse ai do të shkelë rregullat që janë renditur, atëherë do të shkarkohet; nëse do të largohet me dëshirë, atëherë do të bëjë kërkesë për lëvizje paralele dhe këto do të rregullohen me akte nënligjore më pas.

Vilma Bello – Pra, nëse ai nuk shkel rregullat, ai nuk largohet asnjëherë?

Besa Shahini – Jo nuk largohet, pra është një farë statusi emërtimi i tij me certifikatë.

Erzen Tola – Lidhur me vakumin ligjor, në nenin 22 të projektligjit janë përcaktuar afatet ligjore kur ky kriter bëhet i detyrueshëm për drejtuesit e institucioneve. Pra, trajnimi do të bëhet si për drejtorët, ashtu, edhe për nëndrejtorët dhe, duke qenë se janë një numër i konsiderueshëm drejtuesish që do të trajnohen, janë parashikuar edhe afatet ligjore kur bëhet e detyrueshme. Sipas pikës 1 të nenit, është 2 vjet dhe, sipas pikës 2 të nenit, është 4 vjet.

Milva Ekonomi – A ka ndonjë pyetje për të bërë?

Fadil Nasufi – Kjo do të jetë një tip shkolle verore, pra ata që aspirojnë për t'u bërë drejtorë, do ta ndjekin kur t'u ndërpritet sezoni shkollor? A do të jetë *part time* apo do të jetë sistem kualifikimesh, siç bëjmë lidhjen me ciklin e para viteve 90, pra si do të jetë përditshmëria e kësaj shkolle, si do ta ndjekin?

Ky projekt do të jetë vetëm për këtë fazë të parë, po më vonë kush do t'i vazhdojë, se vetëm 2,9 milionë dollarë ka?

Besa Shahini – Modalitetet se si do të funksionojë shkolla *part time*, verës apo në gjysmë viti, kjo do të shikohet në vazhdim, pra janë detaje që janë duke u rafinuar. Besoj se shumë shpejt do të dalim me një dokument që i përfshin të gjitha modalitetet.

Për ta mbyllur atë që thanë kolegët e mi, ky proces është njësoj si procesi i licencimit të mësuesve, pra emërimi i një mësuesi të licencuar kalon nëpërmjet një procesi tjetër, i njëjtë është edhe për drejtorët, ata certifikohen nga shkolla e drejtorëve, ndërsa emërimi i tyre është një proces

krejt tjetër që zhvillohet paralelisht dhe është i rregulluar me nene të tjera të këtij ligji dhe nga akte të tjera nënligjore, pra janë dy procese të ndara në këtë pikë.

Milva Ekonomi – Pyetja e fundit nga Ismeti.

Ismet Beqiraj – Ndërsa lexoj termin “shkolla e drejtorëve” gjithnjë më shkon mendja te kurikula, kjo shkollë a do të ketë kurikul dhe si mendohet të hartohet kjo?

Besa Shahini – Dua të plotësoj edhe pyetjen se kur do të bëhet shkolla. Ne garantojmë ato mësues që janë në punë dhe duan të ndjekin këtë shkollë që të bëhen drejtorë. Ne do t’i rregullojmë aktet nënligjore që t’u krijojmë mundësinë që edhe ata ta ndjekin këtë shkollë. Pastaj konkretisht, se kur dhe çfarë afati do të kenë, ato do të dalin me akte.

Almira Xhembulla – Meqenëse kemi këtu përfaqësuesit e Fondacionit Shqiptaro – Amerikan për Zhvillim dua t’i falënderoj!

Jam e bindur që do të jetë një angazhim shumë serioz dhe mbështetja e tyre është një tjetër garanci që ky proces do të jetë transparent dhe shumë eficient. Duke pasur parasysh edhe eksperiencat e mëdha të mëparshme dhe ndihmën që ka dhënë ky Fondacion, dua t’i falënderoj edhe një herë për ndihmën që japin edhe në këtë nismë të Ministrisë së Arsimit.

Ismet Beqiraj – Edhe pyetja ime, sepse nuk e sqaroi.

Besa Shahini – Edhe kurikula është e njëjtë sikur modaliteti, pra ndërtimi i moduleve dhe përmbajtja është në përfundim e sipër dhe shumë shpejt do të dalim me një propozim të përfunduar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Do të ketë module, të cilat do t’i ndjekin persona që dëshirojnë të kalojnë në këtë trajnim dhe të certifikohen.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po janë kurikula.

Milva Ekonomi – Kush është dakord me nenin 4? Kundër?

Miratohet.

Kalojmë te neni 5. Në pikën 4 të nenit 28 shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje.

A ka komente nga Qendra për Arsim Cilësor? A e keni parë komentin që është bërë?

Besa Shahini – Kjo pikë është shtuar nga propozimet e organizatave që merren me fëmijët me aftësi të kufizuara, pra është propozimi tyre. Neni është siç ka qenë, ne i themi pushteti vendor: ndër gjithë detyrat e tjera që keni ju, do të mbështesni edhe fëmijët me aftësi të kufizuara. Ky është ndryshimi te ky nen, nuk ka asnjë ndryshim tjetër.

Zamira Gjini – Ky nen shoqërohet me një faturë financiare që i ngarkohet pushtetit vendor.

Milva Ekonomi – Fjalën e ka zoti Beqiraj.

Ismet Beqiraj – Në nenin 5 të projektligjit, i cili ndërhyt në neni 28 që, sipas terminologjisë së re që është rregulluar në ky projektligj, nuk do të quhet më njësia bazë e qeverisjes vendore, por njësia e vetëqeverisjes vendore.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pikërisht ndërhyt në neni 28 i projektligjit aktual, që ka të bëjë me kompetencat kryesore të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Këtu unë dua të bëj këtë shtesë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Në nenin 28 fjalia e parë...

Ismet Beqiraj – Ju lutem, më lini ta sqaroj atë që kërkoj.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Lexojeni se çfarë thotë: “në pikën 4 të nenit 28 shtohet”, ky është ndryshimi, ndërsa komenti yt është tek neni 21 i këtij projektligji. A më kupton se çfarë dua të them?

Ismet Beqiraj – Më lejoni ta çoj deri në fund. Në neni 5 që ndryshon, shton pikën 4 të nenit 28. Ligjin e azhurnuar me të gjitha ndryshimet e kam këtu përpara dhe është neni 28 i ligjit të azhurnuar, ku thuhet: “Njësia bazë e qeverisë vendore me ligjin aktual”, po njësia e vetëqeverisjes vendore që është ndryshuar ky term më 2015-en. Në kompetencat kryesore të njësisë së vetëqeverisjes vendore unë dua të bëj këtë propozim, që është në neni 5 i projektligjit, pas gërmes “a” të pikës 2, të nenit 28, të shtohet germa “a/1” me këtë përmbajtje: “Sigurimi i transportit falas të nxënësve me banim jashtë qendrës së banimit, ku kryejnë aktivitet shkollat parauniversitare publike”.

Ky është një shqetësim për të gjithë sistemin e arsimit në zonat rurale, në kushtet e braktisjes së shkollave, të uljes së numrit të nxënësve dhe të krijimit të shkollave rajonale. Kemi fëmijë që shkollat i kanë 5 deri në 10 kilometra larg nga shtëpia. Në u japim detyrim njësive të vetëqeverisjes vendore ruajtjen dhe mirëmbajtjen e të tjera për institucionet arsimore dhe nuk u japim si detyrim sigurimin e transportit. Organet e vetëqeverisjes vendore e kanë si detyrë të neglizhuar deri më tani, ku edhe unë si deputet, nga zona që përfaqësoj, kam ankime nga prindër dhe mësues.

Adelina Rista – Zonja drejtuese, propozimi që bëri Ismeti përfshihet në nenin 21 të projektligjit. Neni 21 përfshin në ligj emërtime që ndryshojnë dhe njësitë e qeverisjes vendore zëvendësohen me njësi të vetëqeverisjes vendore; të gjithë termat e tjerë që ndryshojnë në ligj i përfshin neni 21 i projektligjit. Pra, ky nen i përfshin të gjitha, prandaj të kalohet ky propozim.

Ismet Beqiraj – Të lutem, unë nuk bëra propozim për ndryshime në terminologji, sepse janë të propozuara te neni 21, unë bëra shtesë. Edhe një herë te kompetencat që ka njësia e vetëqeverisjes vendore, unë propozova të ketë edhe sigurimin e transportit falas të nxënësve dhe mësuesve që janë jashtë qendrës së banimit.

Milva Ekonomi – Ky është një propozim që vjen nga komisioni, ju lutem ju, si ministri, më jepni një përgjigje, sepse është e lidhur me disa kushte të tjera që duhet të japim përgjigje.

Erzen Tola – Dua të informoj komisionin lidhur me këtë propozim. Ministria e Arsimit e ka diskutuar për një kohë të gjatë edhe me aktorët e interesit këtë propozim, por e shohim si të pamundur të realizohet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Vitin e kaluar Ministria e Arsimit me vendim të Këshillit të Ministrave ua kishte kaluar këtë kompetencë njësive të vetëqeverisjes vendore dhe shërbimi është realizuar në një përqindje shumë të ulët nga këto njësi, për arsyen e vetme sepse prokurimi i shërbimit në njësi të ndryshme ka arritur në përqindje të ndryshme realizimi, pasi operatorët e transportit nuk kanë treguar interes lidhur me këtë shërbim që do t'u ofrohet nxënësve. Për këtë arsye ministria nuk e propozoi ndryshimin në ligj për ta shtuar këtë kompetencë në njësitë e qeverisjes vendore, por ka një projekt për ta realizuar vetë si ministri për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe të garantojë këtë shërbim në ato zona ku ka nevojë për transport. Realisht është e pamundur. Edhe njësitë e vetëqeverisjes vendore e kanë kundërshtuar, sepse e kanë të pamundur të realizojnë si të ndarë këtë shërbim në teritore të ndryshme të vendit.

Ismet Beqiraj – Zoti përfaqësues i ministrisë, unë jo vetëm që do t'i kërkoj komisionit që ta hedhim në votim propozimin tim, por këtë do ta kërkoj edhe në seancën plenare. Kjo është paaftësi e menaxhimit të këtij detyrimi për një shërbim të rëndësishëm për fëmijët, të cilët janë 5 deri në 10 kilometra larg shkollave dhe të themi se nuk ka performacë, ka këtë dhe atë, ju lutem, kjo nuk më duket serioze aspak, sepse ky është një detyrim që ne duhet t'ua sigurojmë fëmijëve edhe në fshatin më të thellë, ku kemi 2 nxënës.

Milva Ekonomi– Ismet, përfaqësuesi i ministrisë po të shpjegon që ishte performanca e ulët e bashkive dhe nga kjo iu hoq si kompetencë, por do të bëhet një projekt pilot dhe do ta zgjidhë këtë punë ministria, prandaj nuk është vendosur në këtë ligj.

Ismet Beqiraj - Ajo nuk është performancë e dobët e bashkive, por, duke mos e pasur detyrim ligjor...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ma gjeni ligjin ku bashkitë e kanë si detyrim ligjor.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pra, nuk e kanë si detyrim ligjor dhe ata e kanë neglizhuar dhe e kanë lënë pas liste këtë shërbim si shumë shërbime të tjera.

Milva Ekonomi – Hedhim në votim nenin 5 me ndryshimin të pika 4 e nenit 28, sipas propozimit që ka sjellë ministria që shtohet vetëm paragrafi “nxënësit me aftësi të kufizuar” dhe propozimit që ka bërë zoti Beqiraj.

Kush është dakord me propozimin e ministrisë?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kush është dakord me propozimin e zotit Ismet?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem, më lini të mbaroj unë.

Ismet Beqiraj – Dua ta bëj të qartë se ka nxënës që ecin 5 apo 10 kilometra mbi lumenj, mbi përrenj dhe me ujqër që u dalin përpara, sepse kanë dalë edhe ujqër andej.

Milva Ekonomi – Ismet, të lutem më lejo ta mbaroj.

Kemi një nen që po ndryshon nga ligji ekzistues. Nga ministria ka ardhur një propozim sipas rekomandimeve që kanë bërë shoqatat, ku shtohet paragrafi “nxënësit me aftësi të kufizuar” dhe nga zoti Beqiraj është bërë një propozim që të shtohet pika “a/1”, të dyja këto propozime do të hidhen në votë.

Kush është dakord me propozimin e ministrisë?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ejani ta votojmë, pra!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Këtë pjesë do ta shikojë juristi që kemi si këshilltar në komision, do të shikojë nëse kjo gjë është në rregull me Komisionin e Ligjeve.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord, e di ti, ndërsa ne nuk e dime. Tani na lër që të ndriçohemi edhe ne të tjerët.

Kemi pikën ”a/1” që propozon zoti Beqiraj. Nuk ka diskutime, ejani ta votojmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fadil Nasufi – Shërbimin e transportit të fëmijëve e parashikon ligji për vetëqeverisjen vendore, ligji nr. 139/2015, pra e ka me ligj. E kryen apo jo, kjo është një punë tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

I ka kaluar me reformën e decentralizimit dhe në një largësi mbi 5 kilometra ka të drejtë t’u sigurojë transport. Ne e kemi të shprehur në ligj dhe si kompetencë e ka qeverisja vendore për të siguruar transportin dhe qeveria ja subvencionon.

Ismet Beqiraj – Të jap edhe unë mbrojtjen.

Në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e vetëqeverisjes vendore” janë të përcaktuara shërbimet që u bëhen institucioneve të arsimit, restaurimi, ruajtja, mirëmbajta, garantimi i kushteve higjieno-sanitare dhe transporti, dhe jam dakord. Unë po them që këtu kemi një ligj specifik për arsimin parauniversitar dhe kemi në një nen të caktuar, ku ky ligj u delegon kompetenca të drejtpërdrejta dhe të prekshme organeve të vetëqeverisjes vendore.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva, të lutem. Pra, neni 28 i delegon kompetenca të drejtpërdrejta dhe nuk është e tepërt, edhe pse është te ligji “Për organizimin dhe funksionimin e organeve të vetëqeverisjes vendore”. Le ta ketë si detyrim dhe si detyrë shtëpie këtë shërbim, sepse i kemi lënë fëmijët rrugëve.

Këtë ta bëjmë në emër të fëmijëve, që të mos e braktisin shkollën. A e dini që po mbyllen shkollat, sepse ka lëvizje demografike të popullsisë? Do ta çojmë shërbimin atje ku jetojnë, sepse themi pastaj se po boshatiset territori.

Milva Ekonomi – Dakord, e kuptuam, ta lexojmë që ta kuptojmë se çfarë ndryshimi po bëjmë. Te neni 28, pika 4, thuhet: “Njësia bazë e qeverisjes vendore të ndryshojë emërtimin, mbështetur në propozimet e njësive arsimore vendore dhe këshillave të mësuesve të institucioneve. Sipas kriterëve të miratuara në këshillat e njësive vendore, mbështet: nxënësit e familjeve në nevojë, nxënësit me arritje të shkëlqyera, punonjësit e institucioneve arsimore për zhvillimin e tyre profesional dhe për zhvillimin e kurikulës, pajisjen e institucioneve arsimore me mjete arsimore dhe nxënësit me aftësi të kufizuar”. Kjo është ajo që po ndryshon, ndërsa ajo që kërkon ti është në një ligj tjetër dhe nuk ka lidhje me këtë ligj.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk e afekton fare këtë ligj, sepse e ke në ligjin tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord, nuk ka më diskutime. Të lutem, zoti Ismet, nuk ka më diskutime eja ta votojmë.

Ismet Beqiraj – Të lutem, me shumicë votash e kuptoj.

Milva Ekonomi – Nuk është shumicë votash, por është teknikë legislative.

Ismet Beqiraj – A është ligji nr. 69/2012, i azhurnuar me ndryshimet deri në vitin 2015? Po, është i gjithi. Këtu a është neni 28, ku thuhet “njësia bazë e qeverisjes vendore”? A është këtu pika 2, ku thuhet: “Kompetencat kryesore të njësisë bazë të qeverisjes vendore”? Përveç kompetencave të tjera, përfshin ndërtimin dhe rikonstruksionin e godinave, garantimin e paprekshmërinë e institucioneve, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e institucioneve dhe garantimin e kushteve higjiëno-sanitare; këtu unë kam shtuar edhe transportin e nxënësve, edhe ky shërbim është.

Bujar Çela – Propozimi që bëri Ismeti nuk është fare objekt i ligjit. Transportin e mësuesve dhe nxënësve e mbulon Ministria e Arsimit. Në listën e mësuesve që vendos administratori, vendosen edhe nxënësit që i bashkëngjiten këtij transporti. E dyta, pushteti vendor me kompetencat e vendimmarrjes së këshillit bashkiak, subvencionon kur për pagën e transportuesit, që është miratuar nga qeveria, nuk afrohet njeri, atëherë me vendim të këshillit bashkiak dhe me propozim të drejtuesit të shkollës duhet shtuar diçka, si rruga e keqe e të tjera.

Besa Shahini – Zoti Beqiraj, kjo që po ngrini ju, është një çështje shumë e rëndësishme dhe ne duam që njësitë e vetëqeverisjes vendore ta kishin këtë mundësi dhe ta kryenin këtë shërbim, por kjo është bërë pengesë sipas tyre, ngaqë çmimi i biletës është shumë i ulët dhe në një vit të caktuar ata nuk e kanë realizuar si shërbim. Frika jonë është që, nëse e vendosim në ligj, atëherë nuk do të ketë transport për fëmijë në shumë zona, për shkak të financimit që është përcaktuar nga një ministri tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zoti Beqiraj, ne duam shumë që kjo të realizohet dhe duhet të diskutohet edhe me ministrinë që merret me transportin, për rritjen e çmimit të biletës.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Dakord, je marrë me këtë gjë, por lexo logjikën e ligjit, se nuk është ashtu.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord, e hedhim në votë, propozimin e zotit Beqiraj, për të qenë pjesë e nenit 5 të projektligjit që kemi në dorë. Kush është dakord? 5 vota pro. Gjysma tjetër është kundër. Si veprohet në këtë rast?

Gazmend Bici – Nuk miratohet zonja kryetare, sepse duhet të marrë shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm.

Milva Ekonomi – Propozimi nuk u miratua, kalojmë te pika tjetër.

Ismet Beqiraj – Po propozimi im nuk miratohet?

Gazmend Bici – Nuk miratohet, sepse çdo vendimmarrje e komisionit duhet të ketë miratimin e shumicës së anëtarëve të pranishëm. Këtu janë 10 anëtarë dhe votimi ishte 5 vota pro dhe 5 kundër; duhej të merrte 6 vota, prandaj nuk miratohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Neni 6. Pika 4 e nenit 29 ndryshohet si më poshtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kemi një koment nga shoqatat.

Besa Shahini – Edhe për të shtuar përfaqësues nga shoqëria civile dhe nga universitetet duhet të vendosim të gjithë procesin e përzgjedhjes së tyre, ngaqë ka shumë përfaqësues nga organizatat e shoqërisë civile dhe nga universitetet. Kjo duhet të përcillet bashkë me të gjithë procedurën e përzgjedhjes së tyre, pra si do të konkurrojnë, kush do të votojë etj.

Ne nuk jemi kundër, mirëpo kemi dilemën se si do të zgjidhen këta.

Milva Ekonomi – Keni këtu edhe përfaqësimin e Shoqatës së Bashkive, një koment që vjen nga komisioni...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem shumë, të mbarojmë dhe të punojmë shpejt e me devotshmëri për ta kaluar projektligjin! Mbani qetësi që të kuptojmë se çfarë po diskutojmë!

Jemi te neni 6, i cili bën një ndryshim te pika 4 e nenit 29. Ka propozime që vijnë nga shoqatat dhe nga komisioni lidhur me një përfaqësues të shoqatës së bashkive. Janë dy shoqata. Mbase duhen përcaktuar siç kanë qenë në ligjin aktual që po diskutojmë, ku thuhet “një përfaqësues i shoqatës së bashkive, numrin më të madh të bashkive”. Mbase kjo duhet shtuar, sepse edhe kjo kërkon një rregullim në ligj. Ju thoni se nuk mund të merrni në konsideratë organizatat e shoqërisë civile, sepse keni procedurë. Kërkoni, gjithashtu, dy përfaqësues nga

partnerët socialë, domethënë keni venë aty dy partnerë socialë, që mund të jenë sindikatat. Sindikatat e kanë të zgjidhur, por shoqëria civile mbase ka nevojë të përfaqësohet dhe në raste të tilla bëhet një letër dhe vendoset një rotacion.

Besa Shahini – Mund të shtojmë një fjali në fund ku mënyra e përzgjedhjes rregullohet me një akt nënligjor.

Erzen Tola – Zonja kryetare, ne nuk jemi kundër shtimit të përfaqësuesve nga shoqëria civile apo përfaqësuesve nga institucioni i arsimit të lartë, vetëm se duhet qartësuar procedura se si do të vijjnë këta përfaqësues në komision.

Lidhur më Shoqatën e Bashkive jam shumë dakord që të shtohet termi “me numër më të madh të bashkive”, siç ka qenë. Pra, nuk ndryshon asgjë me atë pikë të projektligjit.

Vilma Bello – Komenti im në këtë nen do të ishte ky: në Këshillin Kombëtar të Arsimit Parauniversitar, duke qenë se kemi të bëjmë me faktorë që lidhen me arsimin, të shtohet detyrimisht një përfaqësues nga universitetet.

Milva Ekonomi – Të dëgjojmë edhe juristin e komisionit.

Gazment Bici – Unë kisha një propozim për sa i përket teknikës legislative. Në neni 6 të projektligjit, i shkruar siç është, thuhet që Këshilli Kombëtar i Arsimit Parauniversitar kryesohet nga ministri dhe përbëhet nga 14 anëtarë. Për mendimin tim, kështu siç është shkruar, nuk del i qartë statusi i ministrit. Pra, në projektligj thuhet që këshilli përbëhet nga 14 anëtarë, sado që thuhet se kryesohet nga ministri. Në fakt këshilli përbëhet nga 15 anëtarë dhe në këtë rast statusi i ministrit del në rolin e moderatorit dhe jo të anëtarit. Që ministri të ketë statusin e anëtarit, sipas meje formulimin duhej të ishte kështu: “Këshilli Kombëtar i Arsimit Parauniversitar përbëhet nga 15 anëtarë me këtë përbërje: a) Ministri përgjegjës për Arsimin, i cili është dhe kryesuesi i këshillit”, pastaj vijjnë të tjerët dhe kështu del më e qartë.

Erzen Tola – Në vijim të diskutimit që kemi bërë bashkë, ligji aktual në fuqi ka pikërisht këtë përcaktim dhe ne nuk kemi ndryshuar asgjë. Mënyra e përcaktimit për mua është e saktë. Kjo çështje është diskutuar edhe me Ministrinë e Drejtësisë. Mënyra e të shprehurit është e ndryshme kur përcaktohet apo kur nuk përcaktohet kryetari. Në rastin konkret ligji e ka përcaktuar kryetarin e këshillit dhe përcaktimi është shumë i saktë.

Fidel Ylli – Milva, unë do të bëj një propozim. Duke ditur që në orën 3 kemi përsëri seancë dëgjimore, janë edhe 16 nene, të cilat duhet t'i kalojmë në votim, se debatet janë bërë.

Milva Ekonomi – Komentet kanë ardhur dhe i kemi para, do t'i marrim në konsideratë të gjitha një e nga një.

Fidel Ylli – T'i marrim, por të ecim pak shpejt!

Milva Ekonomi – Për këtë ligj ne ramë dakord për tre ndryshimet: të shtohet një nga shoqëria civile, të shtohet një nga IAL-it, të rregullohet Shoqata e Bashkive, pastaj, për formulime të teknikës legislative do t'ju lutesha të dyja palëve që të bashkëpunoni. Ndërkohë ne kemi rënë dakord për këto ndryshime.

Kush është pro për nenin 6?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 7.

Pas nenit 29 shtohet 29/1 me këtë përbërje. Shikojeni pak! A kemi komente për Këshillin e Prindërve nga shoqatat?

Zamira Gjini – Për Këshillin Kombëtar të Prindërve mund të them se e kemi krijuar modelin dhe është një model fantastik. Për herë të parë kemi këshill kombëtar me 13 njësi arsimore të mëdha dhe kemi përfaqësues si pjesë të gjithë veprimtarisë së Ministrisë së Arsimit.

Milva Ekonomi – Kush është dakord me nenin 7?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 8.

Neni 8 shfuqizon nenin 30.

Zamira Gjini – Është e njëjta gjë si për inspektoratin, ngaqë do të ndryshojë struktura.

Milva Ekonomi - Kush është dakord me nenin 8?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 9.

Ky nen ndryshon pikën 3 të neni 38.

A ka komente nga shoqatat?

Zamira Gjini – Do të bëj një sqarim. Ky nen synon t'u japë drejtorëve të shkollave autonomi financiare, që do të thotë se shkollat dhe drejtorët, nëpërmjet bordit dhe procedurave, të bëjnë projekte, të fitojnë të ardhura dhe t'i përdorin ato për shkollat. Ka pasur një ngërç lidhur me

thesarin dhe ne pikërisht këtë kemi rregulluar këtu, pra t'u japim autonomi financiare drejtorëve të shkollave.

Milva Ekonomi – A keni rënë dakord me Ministrinë e Financave?

Zamira Gjini – Po.

Milva Ekonomi – Kush është pro?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 10, që ndryshon pikat 3 dhe 7 të nenit 42.

Zamira Gjini – Neni 10 ka vetëm një ndryshim: nëse përpara një institucion privat mbyllet vetëm në fund të vitit, sipas ligjit ekzistues, ne kemi shtuar që mund të mbyllet edhe gjatë vitit, kur ka bërë një shkelje, kur është jashtë të gjitha aktet ligjore. Vetëm ky është ndryshimi.

Milva Ekonomi – Dakord.

Të shohim se çfarë komentesh kanë ardhur nga sindikatat për këtë nen!

A kanë ardhur komente nga shoqatat? Nuk kanë ardhur.

Kalojmë në votimin e nenit 10.

Kush është pro?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 11.

Zamira Gjini – Edhe neni 11 ka...

Milva Ekonomi – Nuk ka nevojë për komente, se është më mirë të kalojë në diskutime!

Kush ka komente për nenin 11? Çfarë kanë sjellë shoqatat? Nuk kanë sjellë gjë? As nga sindikatat nuk ka komente?

Dakord.

E hedhim në votim.

Kush është pro nenit 11?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 12, ku bëhen ndryshime në nenin 49.

A ka komente nga shoqatat dhe nga sindikatat? Nuk ka.

Kush është dakord me nenin 12?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 13, i cili ndryshon pikën 3 të nenit 50.

A ka komente? Nuk ka.

Kush është dakord me këtë nen?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 14.

Ky nen ndryshon pikën 2 të nenit 55.

A ka komente nga sindikatat? Nuk ka. Po nga shoqatat? Nuk ka.

Kush është pro nenit 14?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 15 ndryshon nenin 55 dhe e shton atë me nenin 55/1. Emërimi dhe shkarkimi i drejtorëve.

A ka komente nga shoqatat? Nuk ka. Po nga sindikatat? Nuk ka.

A ka komente nga anëtarët?

E hedhim në votim?

Kush është pro?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 16, që ndryshon nenin 57. Profesioni i mësuesit.

A ka komente nga shoqatat? Nuk ka. Po nga sindikatat? Nuk ka.

A ka ndonjë komente nga anëtarët?

E hedhim në votim atëherë.

Kush është pro?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 17, që ndryshon pikën 1 të nenit 60.

Kush ka komente nga shoqatat?

Gazmend Bici – Ka Koalicioni për Arsimin në Shqipëri.

Milva Ekonomi – A e keni parë?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zamira Gjini – Kjo nuk mund të bëhet, sepse ka shumë efekt financiar, rrit numrin e punonjësve, duke pasur parasysh se ky numër është miratuar me ligj dhe ne jemi në një studim. Në fakt, bëhet me udhëzim të ministrit dhe jo me ligj. Numri i miratuar i nxënësve për psikologë është nga 3000 deri në 3500; duam ta ulim dhe ta ndryshojmë. Ne po shohim edhe përvojat e vendeve të tjera.

Milva Ekonomi – Po nga sindikatat ka komente?

A jeni dakord që neni 17 të rrijë kështu siç është?

Kush është pro?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 18, që ndryshon nenin 63.

A kanë ardhur komente nga sindikatat? Nuk kanë ardhur. Po nga shoqatat?

Gazmend Bici – Kemi koment nga Qendra për Arsim Cilësor për pikën 3 të nenin 63.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Erzen Tola – Më lejoni të sqarohem! Te neni i propozuar, te pika 3, kur flasim për nxënësit më aftësi të kufizuar, flasim për të gjitha kategoritë dhe kohëzgjatjet. Ata do të trajtohen deri në momentin që do të gëzojnë këtë status; në momentin që dalin nga statusi nuk do të trajtohen më.

Nuk e kuptoj pse duhet të themi: “kanë dëmtime fizike afatgjata”? Neni i propozuar nga ne i parashikon të gjitha kategoritë dhe nëse e kanë statusin, ato trajtohen.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Sipas kuadrit ligjor në fuqi i kategorizon si nxënës me aftësi të kufizuara, pra shikimin dhe dëgjimin.

Zamira Gjini – Fakti që ne e futëm te pushteti vendor, është pushteti vendor ai që ka përgjegjësi që nga rrafshi i pjerrët dhe gjithçka që duhet për fëmijët më aftësi të kufizuara.

Milva Ekonomi – Kush është dakord që ky projektligj të ngelet siç është?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 19.

Pika 6 e nenit 17 shfuqizohet.

A ka komente të ardhura nga sindikatat apo nga shoqatat?

Zamira Gjini – Edhe këtu janë pyetur sindikatat dhe është marrë mendimi i tyre, se e kanë pasur shumë problem këtë çështje.

Milva Ekonomi – Kush është dakord?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

(Mungese incizimi.)

Zamira Gjini – Po, kjo është bërë, edhe kjo është kërkuar shumë nga sindikatat.

Milva Ekonomi – Kush është pro nenit 20? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 21, është vetëm ndryshim emërimesh që shtrihet në të gjithë ligjin ekzistues; janë ndryshime në terminologji.

Kush është pro nenit 21?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 22 bën fjalë për dispozita kalimtare.

Kush është pro?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Ndërkohë do t'ju lutesha shumë që këtu t'i kushtoni vëmendje Këshillit të Arsimit Parauniversitar, ashtu siç bëmë ne.

Neni 23 është për aktet nënligjore.

Kush është pro?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 24 është hyrja në fuqi

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Natyrisht që jemi dakord të gjithë.

Ju faleminderit shumë!

Kemi lënë nenin 6, i cili është miratuar në parim sipas propozimeve, megjithëse ka nevojë për përmirësime të teknikës legislative, domethënë të gjuhës së shprehur, dhe, për këtë arsye, thamë që këshilltari juridik i Ministrisë të ulet bashkë me këshilltarin juridik të komisionit për të punuar dhe formuluar.

Ju lutem shumë juve që do të merreni me zbardhjen e diskutimeve nen për nen, të punoni me *track changes*, që të ngelin gjurmët e ndryshimeve që bëme ne në komision.

(Diskutime pa mikrofon.)

Erzen Tola – Zonja kryetare, unë mendoj t’i qendrojmë terminologjisë siç e ka sot ligji në fuqi, sepse është terminologjia më e saktë. Ligji i jep funksionin e kryetarit të këtij komisioni ministrit, pastaj numëron numrin e anëtarëve, pra thotë: “Kryesohet nga ministri dhe përbëhet nga 14 anëtarë, që do të shkojnë në 16”. Unë mendoj të ngelemi me këtë terminologji, siç e ka ligji në fuqi.

Gazmend Bici – Kurse qëndrimi im është që të ndryshohet, pavarësisht se në ligj është ashtu, pra të përmirësohet dhe të dalë e qartë që edhe ministri të jetë anëtar i këtij bordi, sepse kështu siç është shkruar, del që e kryeson ministri dhe përbëhet nga 14 anëtarë. Nuk përbëhet nga 14 por nga 17, se u shtuan edhe dy të tjerë. Kur të listohen të gjithë anëtarët e caktuar, ministri të jetë në funksionin e kryesuesit.

Milva Ekonomi – E hedhim në votim.

Kush është dakord për ta mbajtur siç është numërimin e anëtarëve të bordit të Këshillit të Arsimit Parauniversitar?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka?

Miratohet.

Faleminderit!

Kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit.

Kush është dakord në tërësi?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka?

Miratohet.

Ju faleminderit shumë!

Ju uroj ditë të mbarë!

Mirupafshim!

MBYLLET MBLEDHJA

